

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5965
E premte, 27 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

Qalaj vlerëson të arriturat e policisë për vitin 2019



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TË ENJTEN ËSHTË MBAJTUR SEANCA E PARË E LEGJISLATURËS SË SHTATË E KUVENDIT TË KOSOVËS

KONSTITUOHET KUVENDI, KONJUFÇA KRYEPARLAMENTAR



IFAQE 4-5



Pa marrëveshje paraprake në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të enjten është konstituuar Kuvendi i Kosovës. Lideri i LV-së, Albin Kurti, pa konsulta me LDK-në ka propozuar deputetin e partisë së vet, Glauk Konjufcën, për kryetar të Kuvendit, i

cili është zgjedhur me 75 vota për, 27 kundër dhe 6 abstenime. Ky veprim i ka hapur rrugë formimit të qeverisë së re, kurse LDK-ja, e cila shihet si partnerja e vetme e LV-së për formimin e ekzekutivit, nuk ka dhënë ndonjë qëndrim të qartë se si do të vazhdohet më tutje

Avokati i Popullit:
Përdorimi i drogës nga fëmijët është shqetësues



Një muaj nga tërmeti katastrofik i 26 nëntorit në Shqipëri

Të enjten është bërë një muaj nga tërmeti tragjik i 26 nëntorit që tronditi Shqipërinë. Mëngjesin e të martës së 26 nëntorit, në orën 03:54 minuta, Shqipëria u lëkund në mënyrë të tmerrshme, nga një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës rihter. Tërmeti zgjati mbi 30



sekonda dhe tronditi Durrësin, Thumanën e Tiranës, tri zonat më të goditura, por u ndje thuajse në të gjithë Shqipërinë. Në Durrës dhe Thumanë shumë ndërtesa u kthyen në gërmadha, ndërsa 51 qytetarë u nxorën prej aty të pajetë

OPINION

ÇKA SJELL 2020? F. 8

Shkruan:
Blerim REKA



MINISHENGENI, SFIDË APO VETËDIJESIM F. 11

Shkruan:
Blerim MURIQI



AKTUALE



RUÇI URON KONJUFÇËN F. 3

EKONOMI

RËNDËSIA E ENERGJISË EFIÇIENTE PËR QYTETARËT E PRIZRENIT F. 9

60 STUDENTË DHE NXËNËS BËHEN PJESË E KEDS ACADEMY VII F. 9



SPORT

DRENICËN MUND TA BRAKTISIN LOJTARËT KRYESORË F. 20

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Topi: Kosova po lihet jashtë tryezave, Serbia po bëhet partner i parë i Shqipërisë

TIRANË, 26 DHJETOR - Ish-presidenti shqiptar Bamir Topi ka rrëzuar propagandën e qeverisë "Rama", që e justifikon mini-shengenin me Serbinë, me një projekt të nisur nga Bamir Topi gjatë presidencës së tij.

I ftuar në "News 24" Topi deklaroi se nuk ka asnjë të vërtetë në pretendimet e PS.-së. Ai solli në vëmendje faktin se gjatë kohës që ishte president, në çdo takim rajonal punonte që Kosova të ishte e pranishme në tavolina. Ndërkohë, mini-shengeni i qeverisë "Rama", sipas ish-presidentit Topi, po largon Kosovën dhe po kthen Serbinë në partnere të parë të



Shqipërisë.

"Unë ula në tryezë Kosovën dhe kërkoja të ishte në takime rajonale. Sot Serbia po bëhet partner i parë i Serbisë", deklaroi Topi. Ish-presidenti u shpreh se është e papranueshme që për herë të parë në raportet Kosovë-Shqipëri, debatet dhe replikat kanë kaluar në nivelet më të larta të politikës. Ai fajësoi Edi Ramën si njeriun që ka nxitur këto përplasje, të cilat i cilësoi si kthim pas dhe dëmtim të raporteve shtetërore Kosovë-Serbi.

Topi tha se udhëheqësit serbë nuk ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri dhe se kur vjen

puna te Kosova, ata janë të njëjtë. "Udhëheqësit serbë janë njësoj. Çështja e Kosovës është tabu. Presidenti Tadiq shpesh kërkonte t'i zgjidhte problemet me Kosovën me dialog me Shqipërinë, gjë që është refuzuar në mënyrë elegante nga unë dhe qeveria e asaj kohe, sepse po rrëshqisnim në terren paradoksal. Kur pyesnin për kishat serbe në Kosovë, iu kam thënë se duhet të pyesnin Prishtinën zyrtare", tha Topi.

Bamir Topi theksoi se samiti i mini-shengenit u mbjt vetëm dy ditë pasi presidenti serb Aleksandar Vuçiq përdori gjuhë fyese për masakrën e Reçakut.

Qeveria teknike, takohen liderët politikë

Mundësia e zgjedhjes së Qeverisë teknike dhe zhvendosja e mundshme e datës së zgjedhjeve, ka bërë që nesër (e shtunë) të takohen liderët politikë në Shkup, Zoran Zaevi, Ali Ahmeti dhe Hristijan Mickoski

SHKUP, 26 DHJETOR - Nesër (e shtunë) takohen Zoran Zaevi, Ali Ahmeti dhe Hristijan Mickoski. Liderët e tri subjekteve më të mëdha politike do të diskutojnë për Qeverinë teknike dhe zhvendosjen e mundshme të datës së zgjedhjeve. Nga VMRO-DPMNE-ja thonë se janë gati për Qeveri teknike dhe se më 12 prill do të ketë zgjedhje të parakohshme parlamentare.

"Për ne as që bëhet fjalë të mos mbahen zgjedhjet. Nuk është kjo çështje për të cilën vepron kush si të dëshiron. Kishim takim liderësh ku të gjitha partitë politike u morëm vesh. Vetëm njëri nga liderët, duke e ditur se do të humbë dhe nuk do të jetë asnjëherë më kryeministër, po tenton ta mbajë peng të gjithë shtetin. Zgjedhje më 12 prill do të ketë", tha Igor Janushev, sekretar i përgjithshëm i

VMRO-DPMNE-së.

BDI-ja nuk sheh arsye për anulimin e zgjedhjeve. Sipas tyre, anulimi i mundshëm duhet bëhet me konsensus.

"Nuk shoh ndonjë arsye për prolongimin e datës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare kur është vendosur me konsensus nga të gjithë liderët. Fundja nëse do të kishte ndonjë ndryshim kjo do të duhej të ishte me konsensus të përbashkët", tha Izet Mexhiti, nënkryetar i BDI-së.

Ndërkaq, kreu i Kuvendit alarmon liderët politikë se, nëse Qeveria teknike nuk votohet më 3 janar, zgjedhjet e 12 prillit do të ishin jokushtetuese.

"Nëse më 3 janar nuk ka Qeveri teknike, nënkuptohet se nuk mund të ketë zgjedhjeve të parakohshme në përputhje me Ligjin për Qeverinë sepse nëse



organizohen zgjedhjet pa këtë element mund të jenë lëndë trajtimi para Gjykatës Kushtetuese", deklaroi Talat Xhaferi, kryetar i Kuvendit.

Kundër anulimit të zgjedhjeve janë edhe partitë opozitare shqiptare, Aleanca për Shqiptarët edhe Lëvizja Besa. Referuar konsensusit mes subjekteve politike,

më 3 janar Qeveria duhet të marrë karakterin teknik, më 11 shkurt duhet të shpërndahet Kuvendi ndërsa më 12 prill të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Kryeministri Zoran Zaev tashmë disa herë ka paralajmëruar se më 3 janar mund të mos tërhiqet, derisa opozita vazhdon obstrukcionet në Kuvend ndaj lig-

jeve ekonomike, rritjes së pagave dhe pensione. VMRO-DPMNE-ja thotë se do të mbështesin ligjet me interes për qytetarët, përjashtim Ligjit për lëndët narkotike, ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Mbrojtje. Për 40 propozim ligje që duhet miratuar deri më 31 dhjetor, pushteti dhe opozita kanë arritur konsensus.

Henze: Minishengeni, rruga më e thjeshtë e Rusisë për të pasur qasje në rajon

BERLIN, 26 DHJETOR - Këshilltari ekonomik pranë CDU-së, Martin Henze ka reaguar sërish ndaj nismës së kreut të qeverisë, Edi Rama dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq, për të ashtuquajturën "Mini-shengen ballkanik". Henze e ka kundërshtuar ashpër këtë iniciativë, e cila sipas tij, do të shërbejë si urë lidhëse e vendeve euroaziatike për të pasur qasje në rajon. Teksa bën një analizë të marrëveshjes, Henze shprehet se

prapa saj fshihet Rusia, pasi Serbia është ekonomikisht shumë e dobët për të qenë një fuqi rajonale.

"Rusia dëshiron të jetë fuqia e vërtetë, duke u fshehur kështu pas Serbisë. "Shengen" është një zonë ekonomike, BE-ja është një zonë ekonomike dhe Federate ruse është në Bashkimin ekonomik euroaziatik. Çfarë do të thotë kjo? Serbia është anëtare e asociuar e EAEU dhe përmes "Mini-shengenit",



rruga do të jetë më e thjeshtë për vendet euroaziatike, për të pasur qasje në rajon. Meqenëse Shqipëria është aktualisht

anëtare e NATO-s, kjo gjë bëhet e mundur. Kushdo që është pjesë e Bashkimit ekonomik euroaziatik, është gjithashtu një aleat i rusëve", tha ai.

Henze shton më tej se kjo çështje ka dy vjet që diskutohet me Ramën dhe kjo largon më tepër Shqipërinë drejt Bashkimit Evropian, për faktin se ky i fundit është në konkurrencë me Bashkimin ekonomik euroaziatik, i cili tenton të largojë rajonin nga Perëndimi. Sipas

këshilltarit ekonomik të CDU-së gjermane, nisma dëmtton gjithashtu edhe NATON. "Mini-shengen" është gjithashtu një problem për NATO-n. Çfarë synon kjo nismë? Serbia do të ketë garanci për strukturat ekonomike në Shqipëri dhe të sajat, shtohen përpjekjet për të përçarë Kosovën, rusët kanë informacione të hollësishme për Ramën dhe Vuçiqin, kështu që Rama është i detyruar të bindet".

Një muaj nga tërmeti katastrofik i 26 nëntorit në Shqipëri



PRISHTINË, 26 DHJETOR - Të enjten është bërë një muaj nga tërmeti tragjik i 26 nëntorit që tronditi Shqipërinë. Mëngjesin e të martës së 26 nëntorit, në orën 03:54 minuta, Shqipëria u lëkund në mënyrë të tmerrshme, nga një tërmet me magnitudë 6.4 të shkallës rihter. Tërmeti zgjati mbi 30 sekonda dhe tronditi Durrësin, Thumanën e Tiranës, tri zonat më të goditura, por u ndje thajse në të gjithë Shqipërinë.



Në Durrës dhe Thumanë shumë ndërtesa u kthyen në gërmadha, ndërsa 51 qytetarë u nxorën prej aty të pajetë.

Ekipet e kërkimshpëtimit nga Kosova, Greqia dhe vendet e tjera të rajonit dhe Bashkimit Evropian u sensibilizuan menjëherë dhe zbarkuan në Shqipëri, duke gërmuar nën rrënoja për shpëtim jetësh, prej ku arritën të nxirrnin të gjallë 45 persona. Ky ishte tërmeti më i fuqishëm i dekadave të fundit në

Shqipëri dhe që la pas më shumë viktima e shkatërrim.

Tashmë, një muaj pas tërmetit, thajse është bërë bilanci i dëmeve të shkaktuara, njerëzit janë akomoduar nëpër hotele, banesa sociale dhe çadra dimërore, ndërsa vijon puna për mbledhjen e fondeve për nisjen e procesit të rindërtimit.

Shumë vende kanë ofruar ndihmën e tyre për rindërtimin dhe, siç ka deklaruar kryeministri Edi Rama, pritet të nisë së shpejti.

Ruçi uron Konjufcën

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka uruar kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, me rastin e zgjedhjes në këtë detyrë të lartë. Në mesazhin e tij, Ruçi shprehet besimplotë se nën drejtimin e tij të urtë Kuvendi i Kosovës do t'i përballojë e zgjidhë me sukses sfidat e vështira të zhvillimit, përparimit dhe integritetit të Republikës së Kosovës si dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve të saj. "I dashur Glauk, me rastin e zgjedhjes tuaj Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ju uroj nga zemra suksese në këtë detyrë të lartë dhe fisnike. Kam besim të plotë se

nën drejtimin Tuaj të urtë, Kuvendi i Kosovës do t'i përballojë e zgjidhë me sukses sfidat e vështira të zhvillimit, përparimit dhe integritetit të Republikës së Kosovës si dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve të saj. Përvoja juaj e gjatë si deputet, kompetenca dhe përkushtimi me të cilin keni shërbyer si zëvendëskryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, angazhimi i gjatë në media si dhe në mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut janë garanci se Ju do t'i përmbushni me sukses të gjitha objektivat për rritjen e kontributit të Kuvendit si dega legislative e qeverisjes në konsolidimin e institucioneve



demokratike, mirëqeverisjen, integritet euroatlantike, shtimin e njohjeve ndërkombëtare dhe zhvillimin, sta-

bilitetin, fqinjësinë dhe paqen në rajon", është thënë në urimin e Ruçit, i cili ka konfirmuar gatishmërinë e Kuvendit të Shqipërisë

për bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës. "Gjej rastin ta rikonfirmoj vullnetin dhe gatishmërinë e Kuvendit të Shqipërisë, edhe timin personal, se ashtu si deri më sot, bashkëpunimi midis Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës do të rritet e zgjerohet si një nga aspektet më të rëndësishme të bashkëpunimit tonë dypalësh. Për të diskutuar nga afër çështje konkrete të bashkëpunimit tonë të ardhshëm kam kënaqësinë t'ju ftoj për një vizitë zyrtare në Kuvendin e Shqipërisë, në një kohë sa më të afërt", shkruhet në letrën e urimit të kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi.

KDI-ja vlerëson komunat e rajonit të Prizrenit në 20 indikatorë për periudhën janar-dhjetor 2019

PRIZREN, 26 DHJETOR (ER) - Në kuadër të procesit të monitorimit të institucioneve lokale për respektimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në nivel lokal, KDI-ja ka vlerësuar komunat e rajonit të Prizrenit në 20 indikatorë për periudhën janar-dhjetor 2019. Për këtë qëllim, KDI-ja të enjten përmes një takimi ka

diskutuar për mundësitë e dhënies së imputeve të aktorëve institucionalë dhe shoqërisë civile në metodologjinë e vlerësimit dhe dhënien e imputeve në procesin final vlerësues.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin zyrtarë të zyrave për informim dhe drejtorë të drejtorive të administratës nga gjashtë komuna të rajonit të Prizrenit:

Prizren, Dragash, Suharekë, Mamushë, Malishevë dhe Rahovec si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

KDI-ja gjatë janarit do ta publikojë raportin për procesin e konsultimeve publike në këto komuna si dhe shkallën e respektimit të Udhëzimit Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik në komuna.



Të enjten është mbajtur seanca e parë e legjislaturës së shtatë e Kuvendit të Kosovës

Konstituohet Kuvendi, Ko



Pa marrëveshje paraprake në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) të enjten është konstituuar Kuvendi i Kosovës. Lideri i LV-së, Albin Kurti, pa konsulta me LDK-në ka propozuar deputetin e partisë së tij, Glauk Konjufcën, për kryetar të Kuvendit, i cili është zgjedhur me 75 vota për, 27 kundër dhe 6 abstenime. Ky veprim i ka hapur rrugë formimit të qeverisë së re, derisa LDK-ja, e cila shihet si partnerja e vetme e LV-së për formimin e ekzekutivit, nuk ka dhënë ndonjë qëndrim të qartë se si do të vazhdohet më tutje

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Në seancën konstituive të legjislaturës së shtatë, deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Glauk Konjufca, është zgjedhur kryetar i Kuvendit të Kosovës. Pa marrëveshje me Lidhjen e Demokratike të Kosovës, Konjufca ka marrë 75 vota për, 27 kundër dhe 6 abstenime. Gjithashtu, Kuvendi ka zgjedhur pesë nënkryetarët, Arbërie Nagavcin nga LV-ja, Kujtim Shalën nga LDK-ja, Memli Krasniqin nga PDK-ja, Sllavko Simiq nga Lista Serbe dhe Fikrim Damka nga komuniteti turk. Pas betimit të deputetëve të legjislaturës së shtatë, në mënyrë të befasishme, lideri i LV-së, Albin Kurti, ka propozuar Konjufcën për kryeparlamentar, i cili më pas ka marrë votat e nevojshme për t'u zgjedhur në këtë post. Pas zgjedhjes, kryeparlamentari i ri është zotuar se gjatë ushtrimit të funksionit të tij do ta respektojë Kushtetutën e Kosovës. "Ne qysh

në fillim duam t'ju falënderojmë që e themeluar legjislaturën e shtatë. Ju falënderojmë që na besuat këtë detyrë. Ne ju garantojmë që edhe si kryesi që do t'i kryejmë detyrat tona ashtu siç kërkohet me shumë nder sipas Kushtetutës sonë që është në fuqi. I falënderojmë ambasadorët e

pranishëm në këtë seancë dhe të gjithë mysafirët të cilët na kanë nderuar me praninë e tyre në këtë seancë konstituive", ka thënë Konjufca.

Me zgjedhjen e kryetarit dhe pesë nënkryetarëve ka përfunduar procedura e konstituimit të Kuvendit të Kosovës, e cila është udhëhequr

nga deputeti më i vjetër, Jahja Koka, dhe deputetja më e re, Fjolla Ujkani, të dy deputetë nga Lëvizja Vetëvendosje. Ndonëse konstituimi i kuvendit është bërë pa marrëveshje me LDK-në, lideri i LV-së, Albin Kurti, ka shprehur optimizëm se do ta arrijnë një marrëveshje për bashkëqeverisje me partinë e Isa Mustafës.

Pas mbledhjes konstituive, ai ka thënë se do t'i kalojnë të gjitha pengesat për formimin e qeverisë së re. "Me dashamirësi, me interesin e përgjithshëm para çdo lloj interesi tjetër, besoj se do t'i tejkalojmë të gjitha pengesat dhe të kemi edhe qeveri të re ashtu siç e patëm Kuvendin", ka deklaruar Kurti. Kur është pyetur rreth ndonjë takimi të ri me liderin e

LDK-së, Isa Mustafa, Kurti ka thënë se me të janë në kontakt të rregullt. "Ne jemi në kontakt të rregullt. Me siguri që do të kemi komunikim, bashkëpunim dhe takime", është shprehur ai.

I pari i LV-së ka thënë se nuk ka qenë befasi zgjedhja e Glauk Konjufcës kryetar i Kuvendit të Kosovës. "Unë nuk e di kush sa ka qenë në dijeni, por nuk mendoj se mund të ketë qenë befasi", ka thënë Kurti. Ai ka vlerësuar se kjo është një ditë shumë e mirë për demokracinë dhe për shtetndërtimin në Kosovë. "Kuvendi është tempull i demokracisë dhe ligjëvënies, prandaj jam i bindur se me këtë hap kemi treguar një lloj qytetërimi demokratik sepse për dallim nga legjislatura e gjashtë, ne nuk kemi bllokuar konstituimin e institucioneve", ka thënë Kurti.

LDK-ja i qëndron propozimit të Kryesisë

Konstituimi i Kuvendit të Kosovës të enjten është bërë pa marrëveshje mes LV-së dhe LDK-së, të cilat pretendojnë se do të bashkëqeverisin në këtë mandat. Me këtë veprim LV-ja ka injoruar ofertën e fundit të LDK-së, që ia ka bërë pak orë para fillimit të seancës konstituive. I vetmi deputet i LDK-së që e ka komentuar zgjedhjen e Konjufcës në postin e kryeparlamentarit pas seancës ka qenë Lumir Abdixhiku. Shkurtimisht para



njufca kryeparlamentar



ShBA-ja dhe presidenti Thaçi mirëpresin konstituimin e Kuvendit

Ambasada e ShBA-së në Kosovë përmes një deklarate për media ka mirëpritur konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe ka uruar kryetarin e ri të Kuvendit, Glauk Konjufca, anëtarët e tjerë të kryesisë së Kuvendit si dhe të gjithë deputetët e legjislaturës së shtatë. "Ne inkurajojmë liderët politikë që ta formojnë qeverinë e re, që janë zotuar për ta përmbushur mandatin e votuesve. Ne mezi presim që të punojmë me qeverinë e re për çështjet që kanë të bëjnë me paqen, drejtësi-

inë dhe prosperitetin", është thënë në deklaratën e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Edhe presidenti Hashim Thaçi ka uruar deputetët e legjislaturës së shtatë për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Thaçi ka thënë se të gjithë të zgjedhurit e popullit duhet t'i lënë anash interesat politike dhe të punojnë për krijimin sa më të shpejtë të institucioneve të Republikës së Kosovës. "I uroj të gjithë deputetët e

Legjislaturës së Shtatë për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u dëshiruar punë të mbarë në detyrat e tyre. Republika e Kosovës ka sfida të shumta përpara, që kërkojnë nivel të lartë të përgjegjësisë për t'i tejkaluar, prandaj të gjithë të zgjedhurit e popullit duhet t'i lënë anash interesat politike dhe të punojnë për krijimin sa më të shpejtë të institucioneve të Republikës së Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

së kësaj partie se nëse nuk pranohet oferta e LDK-së nga LV-ja për formim të koalicionit qeveritar, LDK-ja tërhiqet nga negociatat për marrëveshje. Sipas tij, oferta e LDK-së përmban pesë pika. "1. Siç është dakorduar tashmë, përgjegjësitë ministrore ndahen proporcionalisht në mes të dy partnerëve qeverisës; 2. Kryeministri dhe një zëvendëskryeministër i Qeverisë i takojnë LV-së; 3. Kryeparlamentari dhe një zëvendëskryeministër i takon LDK-së. Nënkretarët e Kuvendit ndahen sipas rregullimit Kushtetues; 4. Ditën që zgjedhet presidenti i propozuar nga LDK-ja, një ministri e udhëhequr nga LDK-ja i kalon



LV-së, për të bërë proporcionin qeverisës 6 me 4 në favor të kësaj të fundit", ka thënë Mustafa.

Nëse këto nuk merren parasysh nga LV-ja, Mustafa ka deklaruar se LDK-ja është e gatshme të heqë dorë nga të gjitha kërkesat për përgjegjësi dhe të gjitha pozitat t'ia lë LV-së. "5. Nëse LV nuk është gati për propozimin e LDK-së, dhe e sheh LDK-në si pengesë, LDK-ja është e gatshme të heqë dorë nga të gjitha kërkesat për përgjegjësi dhe të gjitha pozitat t'ia lë LV-së. Pra, -ja LDK do të votojë pa asnjë kusht, me 28 deputetët e saj, Qeverinë e LV-së, pa LDK-në në të. U japim edhe kryeministrin, edhe kryeparlamentarin, edhe të 10 ministrinë", është shprehur Mustafa.

gazetarëve, ai ka thënë se LDK-ja s'do të vazhdojë t'i qëndrojë propozimit të Kryesisë së këtij subjekti. "Do të vazhdojmë tutje sipas rregullave kushtetuese në vend. Ne kemi thënë që të gjitha pozicionet kushtetuese në qoftë se partneri potencial vendos që të ndjekë këtë rrugë. I qëndrojmë propozimit të sotëm të kryesisë", ka thënë ai.

Ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës, pak orë para fillimit të seancës konstituive, i ka bërë një ofertë të re Lëvizjen Vetëvendosjes për bashkëqeverisje, e cila nuk është marrë parasysh nga LV-ja. Në një konferencë për media, lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se është vendim i kryesisë

Opozita kërkon që të formohet qeveria

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës, ka falënderuar qytetarët e Kosovës dhe deputetët e dy legjislaturave të kaluara të cilët e kanë votuar atë për kryetar të Kuvendit. Veseli ka thënë se Kosova është shtet i ri dhe nuk do të duhej që spektri politik të krijojë polarizime të qytetarëve. "Sot është konstituuar Kuvendi i Kosovës, përkatësisht institucionet e tij. I

uroj të gjithë qytetarët tanë. Po ashtu, shpresojmë që dita e sotme do t'i hapë rrugë edhe krijimit të institucioneve siç është formimi i qeverisë. Jemi shtet i ri, jemi demokraci e re parlamentare, janë normale rotacionet demokratike. Ajo çka është kryesore nuk duhet t'i polarizojmë qytetarët mes vete, në të njëjtën kohë nuk duhet të krijojmë kriza artificiale të cilat mund ta vënë situatën e qytetarit tanë në një krizë e

cila është sociale, siç është marrja e pagave që nga shkurti, përkatësisht marsi i vitit të ardhshëm", ka thënë Veseli. Kurse deputeti i AAK-së, Daut Haradinaj, ka thënë se nuk u frikësohet zgjedhjeve të reja. "Ne nuk u frikësohemi zgjedhjeve, por meqenëse kishim zgjedhje, ne presim që sa më shpejt ta kemi ekzekutivin e ri. Por, prapëseprapë, ne këtu jemi sido që të vendoset. Tash kemi Kuvend", ka thënë Haradinaj.

Komandanti i FSK-së uron ushtarët për Vitin e Ri



PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Me rastin e festës së Vitit të Ri 2020, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Rrahman Rama, ka uruar të gjithë ushtarët, nënoficerët, oficerët, stafin civil dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, që të festojnë në paqe, harmoni dhe prosperitet festat e fundvitit.

Gjenerali Rrahman Rama në urimin e tij, drejtuar stafit ushtarak dhe civil të MMFSK-së, si dhe qytetarëve të vendit, ka uruar që 2020 të jetë një vit i mbarë për këtë forcë. "Të dashur ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të Forcës së

Sigurisë së Kosovës, shumë të dashur familjarë të pjesëtarëve të FSK-së, ne ushtarët e FSK-së, garantuesit e sigurisë dhe mbrojtjes së Kosovës, në përmbyllje të vitit të parë të tranzicionit dëshirojmë të urojmë që Kosova, atdheu ynë dhe qytetarët të festojnë në paqe, harmoni dhe prosperitet festat e fundvitit. Në radhët tona këtë vit kemi një numër të ushtarëve të rinj që i janë bashkuar FSK-së për të shërbyer me nder dhe dinjitet, andaj uroj që ky vit të jetë një fillim i mbarë në detyrat e shenjta që kemi marrë mbi supë. Duke ju dërguar

mesazhet dhe urimet më të mira për të gjithë ju, kërkoj që respekti, dinjiteti dhe barazia të jenë vlerat që e karakterizojnë FSK-në", ka thënë Rama.

Ai ka theksuar se ushtarakë të FSK-së nga komunitetet joshumicë duhet të ndihen ashtu siç janë pasi, sipas tij, etnia, kultura dhe besimi janë vlera të shtuara për FSK-në. "Ne të gjithë së bashku përbëjmë suksesin, ku synimi ynë është ngritja dhe ofrimi i sigurisë dhe mirëqenies për fëmijët tanë. Urime, shëndet dhe lumturi për ju dhe familjet tuaja!", ka thënë në urimin e tij komandanti i FSK-së.

Arrestohen dy persona për tentim grabitje të armatosur


PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Të enjten nga Njësi të Reagimit të Shpejtë (NjRSh), janë arrestuar dy persona të dyshuar për tentim grabitje të armatosur.

Aksioni është kryer rreth orës 03:00 në rrugën magjistrale Prishtinë - Ferizaj, nga NjRSh-ja, ku janë ndalur dy persona të dyshuar, të cilët po qarkullonin me veturën e tipit VW Polo (me tabelë të një automjeti tjetër).

Gjatë kontrollimit të tyre policia ka gjetur dhe sekuestruar: një

armë automatike AK 47, një karikator me 6 fishekë, tri palë doreza, targat e veturës (që dyshohen të jenë të vjedhura) dhe vetura si dhe gjësende të tjera, të cilat mund shërbejnë si dëshmi në procedurë. "Personat e arrestuar, të cilët dyshohet të jenë të përfshirë edhe në raste të tjera të natyrës së njëjtë: D. T., mashkull, 21 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës dhe B. B., mashkull, 21 vjeç, shtetas i Republikës së Kosovës. Pas inter-

vistimit nga ana e hetuesve rajonalë si dhe marrjes së vendimit nga ana e prokurorit janë dërguar në qendrën e mbajtjes, për përfundimin e të gjitha veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale para se rasti t'u kalojë institucioneve kompetente. Ndaj tyre janë iniciuar rastet: Grabitje në tentativë, vjedhje e rëndë dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës.



ZKA-ja prezanton raportin e performancës 'Siguria e ushqimit, rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit'

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) të enjten ka bërë prezantimin publik të raportit të performancës "Siguria e ushqimit, rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit", në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Komuna e Gjilanit, shoqëria civile dhe mediat. Me këtë rast zëvendësauditatori i përgjithshëm, Ilir Salihu, ka thënë se qëllimi i këtij auditimi ka qenë identifikimi i sfidave në sistemin e sigurisë në tërë zinxhirin ushqimor, si dhe dhënia e rekomandimeve për ta përmirësuar sigurinë në ushqim. Salihu ka theksuar se mungesa e koordinimit adekuat në mes të institucioneve qendrore dhe lokale po krijon vështirësi në kryerjen e punëve si duhet. Sipas Salihut, një problem tjetër vazhdon të mbetet edhe mostransferimi i inspektorëve nga komunat tek Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Ndihmësauditatori i përgjithshëm, Vlora Spanca, ka prezantuar konkluzionet kryesore të këtij raporti, me ç'rast tha se auditimi ka nxjerrë në pah se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ende nuk e ka plotësisht funksional sistemin e sigurisë në tërë zinxhirin ushqimor. Ajo ka theksuar se AUV-i ende nuk ka një regjistër të



plotë të kompanive që merren me tregun e produkteve me prejardhje bimore e shtazore dhe kjo e rritë rrezikun që Agjencia të mos ketë shtrirje të kontrollit në tërë tregun për produkte bimore dhe shtazore. "Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si organ përgjegjës për të ofruar siguri në ushqim ka hartuar rregullore dhe procedura standarde të operimit dhe listat kontrolluese, të cilat i shfrytëzon për sigurinë e ushqimit. Megjithatë, auditimi ka nxjerrë në pah se këto procedura nuk mbulojnë tërë procesin e sigurisë së ushqimit në treg dhe ato nuk janë duke u zbatuar mjaftueshëm për të siguruar se

ushqimi është i kontrolluar si duhet dhe ka siguri për konsumatorin. Listat kontrolluese të cilat i përdor AUV-i nuk adresojnë të gjitha kërkesat për ushqim si dhe parimet Analizës së Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik i njohur si HACCP", është shprehur Spanca.

Më tutje, Spanca ka deklaruar se inspektorët komunalë nuk janë transferuar në AUV si dhe nuk ka koordinim të mirë të kontroleve në mes nivelit qendror dhe atij lokal.

Ndërkohë, udhëheqësi i Departamentit të Auditimit të Performancës dhe Teknologjisë Informative, Samir Zymberi, ka

treguar se auditimi ka mbuluar periudhën e vitit 2018 dhe gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019. Zymberi ka thënë se objektivë e këtij auditimi ka qenë që të vlerësohet nëse në institucionet përgjegjëse është vendosur një sistem adekuat për të ofruar siguri në ushqim. "Rezultatet e auditimit tregojnë se përkundër përpjekjeve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, siguria në ushqim mbetet ende një sfidë e cila kërkon veprime të mëtutjeshme përmirësuese në këtë proces", është shprehur Zymberi. Ai ka treguar se me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së sigurisë së ushqimit Zyra Kombëtare e

Auditimit ka dhënë 15 rekomandime për Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Kurse udhëheqësja e ekipit, Fehrie Thaqi, ka prezantuar para të pranishmëve në detaje të gjeturat e raportit "Siguria e ushqimit, rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit". Përfaqësuesit e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe të Komunës së Gjilanit janë pajtuar me të gjeturat e raportit të auditimit të performancës "Siguria e ushqimit, rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit" si dhe kanë shprehur gatishmërinë për t'i zbatuar rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

ShSKUK-ja blen aparate të reja për hemodializë në Spitalin e Mitrovicës

Mitrovicë, 26 dhjetor (ER) - Spitali i Përgjithshëm i Mitrovicës është pajisur me aparaturë të re, të dorës së fundit, për shërbime të hemodializës.

Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka ndarë më shumë se

200 mijë euro për 12 aparate, pajisjet e reja dhe ozomozë rezervë, të cilat po qëndrojnë në hapësirat, ku është paraparë të vendoset Reparti i Hemodializës. Ndërkaq, në tërësi për blerjen e aparaturës për këtë spital janë shpenzuar mbi 500 mijë euro. Në funksion të përmirësimit të

kushteve infrastrukturore, ShSKUK ka dhënë edhe 67 mijë euro nga buxheti i vet për renovimin e objektit.

Aktualisht, Reparti i Hemodializës ofron shërbime në hapësirat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë.



Qalaj vlerëson të arriturat e policisë për vitin 2019

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Policia e Kosovës ka organizuar të enjten një ceremoni përmbyllëse për fundvit, ku të pranishëm kanë qenë personalitete të larta vendore e ndërkombëtare, përfshirë zyrtarë policorë të profileve të ndryshme.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, gjatë fjalimit të tij ka prezantuar të arriturat dhe rezultatet pozitive të kësaj periudhe kohore të këtij viti si dhe sfidat me të cilat është ballafaquar Policia e Kosovës. Këto të arritura Qalaj ua ka dedikuar zyrtarëve policorë në terren, njësiteve policore, hetuesve policorë e të gjithë atyre, përfshirë stafin civil dhe atë menaxhues, që me punën e tyre të pakursyer kanë arritur me sukses t'i realizojnë objektivat strategjike të PK-së, të orientuara drejt ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, parandalimit të krimit dhe arritjes së

rezultateve pozitive në të gjitha fushat policore.

Ndërkaq kryeministri në detyrë Ramush Haradinaj ka thënë se secili qytetar që i beson policisë së vendit është meritë për suksesin e tyre. "Të gjithë qytetarët e të gjitha komuniteteve kudo që janë janë fitues nëse policia jonë është e suksesshme sepse jeta e tyre, e fëmijëve të tyre, e pronës e të drejtave të tyre janë të garantuara dhe unë u bëj thirrje qytetarëve të vendit pa dallim të ndonjë përkatësie, që t'i besojnë Policisë së Kosovës sepse është policia e tyre, është garanci për një jetë të qetë dhe garanci për respektim të secilit dhe secilës", ka thënë Haradinaj.

Para të pranishmëve, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka theksuar se sot janë bashkë në përmbyllje të një viti për ta nderuar punën e policës, policit, që nga ata që janë në terren gjithë kohës e deri te gjithë stafi e ata që kanë mundësuar që ta përmbyllim një vit të suksesshëm në rendin publik,



qetësinë publike, që siguria e jetës, e pronës e të drejtave të njerëzve tanë të ndodhë pa dallim, pa diskriminim, çdo kund në vendin tonë si në jug, si në veri, si

në lindje e perëndim, kudo që jemi. "Është me rëndësi që Kosova ka qenë e kujdesshme dhe e ka kthyer në fokus pozitën e Policisë së Kosovës, gjendjen

edhe në aspektin material dhe financiar, pra përkrahjen, pagat dhe koeficientet e rrezikshmërisë, orët shtesë e çështje të tjera kyçe për jetën dhe integritetin profesional dhe familjar të policit. Ende ka punë për t'u bërë dhe do të vazhdojmë ta bëjmë Ligjin për pensionet, për sigurimet shëndetësore", është shprehur Haradinaj.

Ndër të tjera, kryeministri në detyrë, Haradinaj, ka thënë se i beson policisë së Kosovës, e ka parë në punë dhe e di se nuk e ka lehtë ta sigurojë rendin publik në një vend që është në tranzicion ende, ku përgjegjësitë e rendit publik dhe të sigurisë janë të organizuara në atë mënyrë që ka plot partnerë, plot komponentë të sigurisë. "E kemi KFOR-in, ka edhe një rol të EULEX-it në vend, pastaj ushtria jonë është në proces të marrjes së përgjegjësi të plota, por policia e ka mbuluar vakuumin më të madh të mundshëm të përgjegjësisë në rendin publik dhe siguri dhe ju inkurajoj që këtë përgjegjësi ta ndieni edhe në të ardhmen. Mos lejoni që të krijohet vakuum që të shfrytëzohet prej armiqve të rendit publik dhe sigurisë dhe të përfitojnë terrorizmi dhe mekanizmat që janë të motivuar armiqësisht ndaj Kosovës", ka deklaruar Haradinaj. Pas fjalimit, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, falënderoi drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, Rashit Qalaj, për angazhim profesional të tij në krye të Policisë, duke i dhënë medaljen e kryeheroit "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu" ndërsa nga drejtori Qalaj, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për Policinë e Kosovës, kryeministri në detyrë, Haradinaj, pranoi mirënjohje. Nga një fjalë rasti e mbajtën edhe ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj.



Avokati i Popullit: Përdorimi i drogës nga fëmijët është shqetësues

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Avokati i Popullit, në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësisë të veta ligjore, ka publikuar raportin me rekomandime Ex-officio nr. 489 /2018, lidhur me përdorimin e substancave narkotike nga fëmijët.

Rasti është hapur sipas detyrës zyrtare me qëllim të vlerësimit të gjendjes aktuale rreth përdorimit të substancave narkotike nga fëmijët në Kosovë dhe adresimit të rekomandimeve tek institucionet

përkatëse, në mënyrë që t'i ndër-marrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike.

Avokati i Popullit, pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, informatave të marra nga institucionet e ndryshme dhe OJQ-ve dhe të dhënave që i ka, vlerëson se përdorimi i drogës nga fëmijët është shqetësues, shtoi faktin e rënies të moshës së përdoruesve, e cila nga viti në vit ka arritur t'i prekë edhe fëmijët e moshës 10-vjeçare.

Po ashtu, në këtë raport Avokati i

Popullit konstaton se ekziston mungesë e qendrave të specializuara për trajtimin e të rinjve përdorues të substancave narkotike dhe mungesë të programeve përkatëse vetëdijësuese dhe parandaluese si dhe mungesë e shërbimeve dhe trajtimit të përdoruesve të substancave narkotike si për nga shtrirja gjeografike, po ashtu edhe për nga cilësia.

Më tutje, Avokati i Popullit konstaton se ekziston mungesë e ekspertizës te punonjësit e qendrave për punë sociale për t'u marrë me rastet e fëmijëve që përdorin substancat narkotike në kuadër të

mandatit të tyre ligjor.

Gjithashtu, ky raport jep rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me veprimet që duhet t'i ndër-marrin Ministria e Shëndetësisë, Policia e Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës në drejtim të përmirësimit të gjendjes aktuale. Ky raport me rekomandime është përcjellë tek autoritetet përgjegjëse dhe është publikuar në uebfaqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.



Çka sjell 2020?



Shkruan: Blerim REKA

Parashikimi meteo-gjeopolitik për vitin 2020 është se në hemisferat euroatlantike dhe euroaziatike do të dominojnë klima të ndryshueshme. Pasojat e përplasjeve të ciklonit veri-perëndimor me atë veri-lindor do të ndihen edhe në Ballkanin jugor. Në fillim, akulli polar do të ftohë jo vetëm kontinentin, por edhe ujërat e nxehta mesdhetare. Vetëm nga gjysma e dytë e vitit, fryma atlantike do ta kthjellojë qiellin evropian. Mirëpo, mjegulla e Brukselit as këtë vit nuk do të shpërndahet nga dielli ballkanik. Do të kemi, pra një vit dinamik me zgjedhje presidenciale në ShBA e Ballkan dhe ndryshime në BE dhe NATO: i pari do të zvogëlohet për një anëtar, e dyta do të shtohet për një më shumë.

Trump do të luftojë për mandatin e dytë, Johnsoni për mandatin e parë jashtë BE-së, Merkel do të mbetet pa mandat, e Macroni do të luftojë për mandat të liderit evropian: me "sovrانيتet evropian" e ushtri evropiane karshi NATO-s.

Kryeministri britanik, Johnson, ndonëse ruajti postin, do t'i mbetet ta ruajë Britaninë e Madhe. BREX-it hapi rrugën për daljen nga BE, por edhe SCOTEXIT për daljen e Skocisë nga Mbretëria e Bashkuar.

Në maj, vështirë që Samiti i Zagrebit për Ballkanin Perëndimor do ta shpërndajë mjegullën e Brukselit nga rajoni, sepse vetë Ballkani do të kalojë nëpër një vit elektoral, me kriza qeveritare që do t'i vonojnë reformat evropiane. Pranvera politike ballkanike do të vonohet për aq sa diplokracia do t'i amnistojë shtetarët e kapur nga oligarkët mafiozë.

Duke toleruar kriminelët shtetërorë, ndërkombëtarët ndoshta do ta mbajnë stabilitetin, por do ta humbin rajonin: ku askush më nuk i beson karikatursë së gjyqësorit

e ku sundimi i shtetarit është mbi sundimin e ligjit.

Edhe më 2020 do të vazhdojë zbrazja e shtetit, paralelisht me mbushjen e sirtarëve gjyqësorë me lëndët e pluhurosura. Gjermania nga 1 marsi do t'i hapë kufijtë për punëtorët ballkanikë, por nga 1 korriku do t'i mbyllë për emigrantët aziatikë. Kështu, Ballkani do të zbrazet nga ballkanasit e do të mbushet nga joballkanasit. Pas

mbylljes së kampeve në Turqi, rajoni do të shndërrohet në strehimore refugjatësh - para kufijve të BE-së.

Dialogu Kosovë - Serbi, edhe nëse rinis në fillim të vitit, vështirë do të përfundojë në fund të tij. Trump do të preferojë një "Camp David Ballkanik" - para fillimit të fushatës presidenciale, por tetë vjet të "Dialogut të Brukselit" vështirë do të mund të finalizohen me

tetë muaj të "Dialogut të Uashingtonit".

Në shkurt, me samitin përmblyllës në Beograd, Serbia do ta bëjë përpjekjen e fundit që me "Unionin Ballkanik" ta zëvendësojë Unionin Evropian, e në favor të Unionit Euro-Aziatik. Ndërkaq, në fund të vitit, uragani atlantik do t'i shtyjë erërat siberiane jashtë Ballkanit. Urime festat e fundvitit, urime 2020!



Gati gjysmë viti pa qeveri funksionale

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Vonesat e krijuara me procesin zgjedhor dhe së fundi edhe për arritjen e marrëveshjes për koalicionin qeverisës për formimin e institucioneve të reja, nga ekspertë të çështjeve ekonomike dhe përfaqësues të bizneseve po konsiderohen me pasoja të mëdha dhe të pariparueshme në ekonominë e vendit.

Janë bërë më shumë se pesë muaj që kur Kosova funksionon me qeveri në detyrë, pas dorëheqjes së kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.

Lëvizja Vetëvendosje si fituese e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit ende nuk ka arritur të bëjë marrëveshje për koalicionin qeverisës me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se vonesat në krijimin e institucioneve të reja pengojnë një sërë zhvillimesh, duke përfshirë këtu edhe mosmiratimin e disa ligjeve që do të sillnin përfitime për sektorin privat. "Janë ligjet tatimore që kanë qenë në proces të plotësim-ndryshimit dhe të cilat mbesin në pritje të krijimit të kuvendit të ri dhe qeverisë së re, e cila do të duhej t'i procedonte të njëjtat tek Kuvendi i Kosovës. Është Ligji për Gjykatën komerciale pastaj i cili që do t'i hapte



rrugë krijimit të një gjykate që do t'i trajtonte kontestet e natyrës komerciale. Por, ajo që është më e rëndësishmja, është aprovimi i projektligjit për buxhetin e vitit 2020, i cili do t'i lejonte shpenzimet për qëllimet e investimeve kapitale dhe do t'i mundësonte sektorit privat të kishte qasje në këto kontrata të qeverisë, qoftë për produkte, qoftë për shërbime", ka thënë Zeka.

Në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, Qeveria e Kosovës deri më 31 tetor ishte dashur ta kishte të miratuar buxhetin e propozuar dhe ta dër-

gonte atë në kuvend, por kjo nuk ka ndodhur për shkak të procesit zgjedhor.

Haki Shatri, këshilltar i kryeministrit në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pohuar për "Radion Evropa e Lirë" se për aq kohë sa nuk formohen institucionet e reja, do të ketë dëme ekonomike dhe vonesa në çdo projekt investiv. "Nga një janari, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, mund të procedohen pagesa vetëm për paga për transferime sociale dhe për ndonjë obligim ndërkombëtar, siç janë kreditë, kurse asnjë

pagesë e paautorizuar me ligj nuk mund të procedohet që ka të bëjë me realizimin e projekteve investive. Pra, dëmi në ekonomi nga vonesa e konstituimit të Kuvendit fillon nga 1 janari", ka thënë Shatri.

Profesori i ekonomisë, Muhamet Sadiku, ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se Kosova mund të futet në një vakum institucional serioz dhe se kjo situatë do të krijojë indikacione negative ekonomike dhe sociale. "Ajo që duhet theksuar nëse futemi në këtë vakum, ambienti i të bërit biznes në Kosovë po përkeqëso-

het edhe më tepër. Kosova në aspektin politik bëhet një vend jostabil për investime afatgjata. Kosova nuk ka politika ekonomike, pasi nuk ka qeverisje efektive, prandaj çdo vonesë i rrezikon edhe projektet e filluara më parë dhe bllokoi iniciativat e reja në formë të projekteve dhe aktiviteteve për dinamizmin e zhvillimit ekonomik", është shprehur Sadiku.


Në të kaluarën në Kosovë, pas zgjedhjeve, konstituimi i institucioneve të reja zakonisht ka hasur në vështirësi. Pas zgjedhjeve të vitit 2017 krijimi i shumicës parlamentare në Kuvendin e Kosovës kishte qenë një sfidë e vërtetë për koalicionin fitues të zgjedhjeve të atëhershme të 11 qershorit, i quajtur koalicioni PAN, i cili më vete kishte përfshirë Partinë Demokratike të Kosovës, Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismën për Kosovën.

Koalicioni ishte arritur të krijohej pas tre muajsh që nga mbajtja e zgjedhjeve.

Një kohë më të gjatë të krijimit të institucioneve të reja kishte ndodhur në zgjedhjet parlamentare të vitit 2014.

Në atë kohë koalicioni qeverisës ndërmjet Partisë Demokratike dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës ishte arritur të bëhet pas gjashtë muajve nga mbajtja e zgjedhjeve.

Rëndësia e energjisë eficiente për qytetarët e Prizrenit



Prizren, 26 dhjetor (ER) - EC Ma Ndryshe ka realizuar një iniciativë që për qëllim ka pasur promovimin e përdorimit të energjisë eficiente te qytetarët dhe për realizimin e një hulumtimi mbi rëndësinë që ka kursimi i energjisë për ta. Për ta kuptuar rëndësinë që ka energjia eficiente te qytetarët EC ka dizajnuar një pyetësor i cili ka përmbajtur disa pyetje që kanë synuar të kuptohet mënyra e shfrytëzimit të energjisë nga ta dhe interesimi i tyre për shfrytëzimin e energjisë që do të rezultonte me një nivel më të ulët të ndotjes së ambientit.

Gjatë realizimit të këtij pyetësori secilit qytetar të anketuar i është dhuruar një poç LED me qëllim të promovimit të mëtejshëm të përdorimit të energjisë eficiente. Qytetarët gjatë realizimit të

pyetësorit janë informuar njëkohësisht për përfitimet që sjell përdorimi i këtyre poçave. Poçat LED të dhuruar qëndrojnë rreth 2 5000 orë dhe, edhe pse janë 12W, ndriçojnë sa një poç inkandeshent prej 120W, duke rezultuar kështu me një kursim prej 90 përqindësh të energjisë elektrike.

Në kuadër të këtij hulumtimi EC ka ofruar edhe një paraqitje grafike të të dhënave të dala. Në bazë të të dhënave të nxjerra nga ky hulumtim del se gjendja është shqetësuese sa i përket mënyrës së shfrytëzimit të energjisë dhe mbrojtjes së ambientit. Nga statistikat shihet se 63.2 për qind e qytetarëve ende ngrohen me dru dhe 20.8 për qind ngrohen me rrymë elektrike, krahasuar me alternativa ekologjike ku paraqitet një përqindje e vogël.

Problemet e ndotjes së ajrit dhe çështjes së shpyllëzimit janë çështje që ndërlihen drejtpërdrejt me këto të dala.

Në anën tjetër, qytetarët, sipas të dhënave, del se janë të shqetësuar nga kjo ndotje dhe dëmet ambientale dhe shëndetësore që po shkaktohen. Pyetjet e tjera kanë pasur të bëjnë me interesimin që kanë qytetarët për kursimin e energjisë në shtëpitë e tyre, shqetësimin mbi rritjen e kostos së përdorimit të energjisë elektrike, përdorimin e llambave eficiente dhe arsytet që do t'i motivonin ata ta zvogëlonin përdorimin e energjisë. Të gjitha të gjeturat nga këto pyetje janë të paraqitura në grafikonin e bashkangjitur.

EC Ma Ndryshe vazhdon të bëjë thirrje që të promovohet më tej përdorimi i energjisë eficiente si

një mënyrë për mbrojtjen e ambientit dhe si një hap drejt praktikave të gjelbra.

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile

(KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA) dhe nga projekti "Përkrahja e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë", financuar nga Qeveria e Duketit të Madh të Luksemburgut dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).



60 studentë dhe nxënës bëhen pjesë e KEDS Academy VII

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Nis rrugëtimin gjenerata e shtatë e KEDS Academy. Tanimë janë për zgjedhur 60 kandidatë të cilët do ta ndjekin programin profesional dhe akademik njëvjeçar. Këtë vit kemi një rritje të numrit të kandidatëve, janë 40 nxënës të cilët vijnë nga shkollat e mesme profesionale nga vende të ndryshme të Kosovës dhe 20 studentë, 18 nga të cilët janë të profilit Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike, një student nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës dhe një nga Fakulteti Ekonomik. Pra, këtë vit numri i ndjekësve të programit arrin në 60.

Ky program ndihmon studentët në zhvillimin e mëtutjeshëm profesional si dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës. KEDS Academy ka startuar në

vitin 2013, në vitin kur KEDS ka filluar operimin në Kosovë. Deri më tani janë aftësuar dhe certifikuar 300 studentë që kanë dalë nga gjashtë gjenerata të KEDS Academy.

Një numër i madh prej tyre janë të punësuar në KEDS dhe një pjesë e tyre sot kanë pozita të rëndësishme në kompani duke luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të saj. Studentë e KEDS Academy vlerësohen edhe nga organizata prestigjioze, ku këtë vit u përzgjedhën nga MCC katër ish-studente të KEDS Academy për studime të mëtejshme në fushën e energjisë në universitetet amerikane.

KEDS Academy është vlerësuar edhe nga organizatat botërore duke fituar shumë çmime në fushën e përgjegjësisë shoqërore anekënd globit.

Takim i përbashkët MSh-ATK për rregullimin e çmimit të barnave

PRISHTINË, 26 DHJETOR (ER) - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiçi, kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës, Arianit Jakupi, kryeinspektori farmaceutik Shaban Osmanaj, dhe i deleguari nga kryeshefi ekzekutiv i AKPPM-së, Lutfi Mulaku, kanë zhvilluar të enjten një takim të përbashkët me drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj dhe zëvendësrektorin Nahit Sharku.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019 për rregullimin e çmimit të produkteve dhe pajisjeve mjekësore dhe zbatueshmërinë e plotë të tij, duke u harmonizuar në nivel



institucional përmes zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta, të cilat do të mundësojnë që ky udhëzim administrativ të jetë plotësisht i mbikëqyrur gjatë zbatimit.

Krerët e ATK-së kanë shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në mënyrë që një politikë e tillë shtetërore të jetë në funksion të plotë të qëllimit për të cilin edhe është aprovuar.

Shoqata Zejtare e Prizrenit dhuron donacion prej 2 000 eurosh për familjen Abazi

GJILAN, 26 DHJETOR (ER) - Shoqata Zejtare Afariste nga Prizreni i ka dorëzuar të enjten familjes Abazi një donacionin në vlerë prej 2 000 eurosh. Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, e ka pritë në takim kryetaren e Shoqatës Zejtare Afariste, Ymran Fusha, nënkryetarin Armend Jakupi dhe sekretarin Hasan Krasniqi, të cilët i ka falënderuar për zemërgjerësinë me këtë familje pas tragjedisë së

tërmetit në Shqipëri. Kryetarja e kësaj shoqate, Ymran Fusha, ka deklaruar se i është bashkangjitur aksionit të kryetarit Lutfi Haziri. "Pak nga ne, shumë për ata", duke thënë se kjo është më e pakta që mund ta bëjnë për këtë familje. Përndryshe, familja Abazi nga Livoçi i Epërm i Gjilanit ka humbur dy djemtë e saj, Isën e Shemsedinin, në tërmetin që kishte goditur Shqipërinë më 26 nëntor.



Nxënësit e shkollës 'Fehmi Lladrovci' marrin vendin e parë në garat e 'STAR-UP'

Drenas, 26 dhjetor (ER) - Nxënësit e Shkollës së Mesme Profesionale "Fehmi Lladrovci" në Drenas kanë arritur ta marrin vendin e parë në garat e organizuara nga ICKosovo-START-UP Social Venture Workshop.

Nxënësit e kësaj shkolle, Rijad dhe Venis Morina, Izet Gashi, Argjend Çelaj dhe Lavdim Ajazi, kanë marrë vendin e parë me projektin e tyre "XKOM" dhe kanë fituar shpërblim në vlerën prej 5 000 eurosh. Në këtë garë kanë marrë pjesë

nxënësit e shkollave të mesme nga i gjithë vendi dhe kanë garuar 400 projekte. Drejtori i shkollës "Fehmi Lladrovci", Lulzim Nika, ka falënderuar nxënësit për këto të arritura dhe profesorin Visar Krelani dhe ka inkurajuar që të vazhdojnë me projekte të tilla.

40 të rinj nga Kamenica do të trajnohen në fushën e teknologjisë dhe kodimeve



KAMENICË, 26 DHJETOR (ER) - "Open Data Kosovo" në kuadër të "Programit Rajonal mbi Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor", të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ka bërë bashkëpunimin e radhës me Komunën e Kamenicës. Zyrtarë nga Komuna e Kamenicës janë takuar me përfaqësuesit e "Open Data

Kosovo" të cilët kanë realizuar projekte edhe më herët në këtë komunë. Projekti i dytë që do të realizohet në Kamenicë është "Code4 Kamenica", që ka për qëllim fuqizimin e të rinjve përmes zhvillimit të shkathtësive të TIK, në të cilin do të përfshihen trajnime për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të Kamenicës. "Pas trajnimit do të ketë edhe aktivitete të përbashkëta, ku do të kodohet një aplikacion në kuadër të

platformës 'EduPerformanca' që do të shërbejë shumë në fushën e arsimit. Kjo organizatë, përveç trajnimit, do të dhurojë si donacion edhe 10 kompjuterë të rinj në të cilët do të mbahet trajnimi. 40 të rinj nga Kamenica do të kenë mundësi të trajnohen në fushën e teknologjisë dhe kodimeve. 20 të rinj do të jenë nga shkollat fillore dhe 20 të rinj nga shkollat e mesme", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.

Përurohet objekti i ri i shkollës "Dituria" në Kaçanik

KAÇANIK, 26 DHJETOR (ER) - Është përuar objekti i ri i Shkollës Fillore "Dituria" në Ivajë të Kaçanikut. Kryetari i kësaj komune, Besim Ilazi, ka uruar nxënësit, mësimit dhe prindërit për objektin e ri shkollor, duke shtuar se tashmë po përmbushet edhe një objektiv i institucioneve komunale për ndërtimin e shkollave të reja si dhe për krijimin e kushteve sa

më të mira për mësimit. Ilazi ka thënë se është një moment i veçantë dhe një dritë shprese për të ardhmen e vendit. Edhe drejtori i kësaj shkolle, Nexhat Luta, ka uruar nxënësit dhe mësimit për objektin e ri shkollor derisa ka premtuar suksese të reja. Ai ka thënë se objekti i vjetër tashmë nuk kishte kushte për mësimit si dhe ishte bërë një vend i rrezikshëm

për nxënësit. Më tutje, Luta ka falënderuar institucionet komunale për investimet e realizuara në këtë objekt. Nxënësit, mësimit dhe prindërit i ka uruar edhe zëvendësministri në detyrë i Arsimit, Azem Guri. Ky objekt i ri shkollor është komplet investim nga Komuna e Kaçanikut, ndërsa ka kushtuar mbi 100 mijë euro.



Minishengeni, sfidë apo vetëdijesim



Shkruan:
Blerim MURIQI

Iniciativa rajonale për katër liritë, të cilat e bënë BE-në ta ndërtojë identitetin konkurrues me faktorët e tjerë të globit dhe t'i mbyllë njëherë e mirë armiqtë, apo Shengeni toka e premtuar e gjithë vendeve të lindjes që dolën nga perandoria moniste po shkon drejt fundit. Se cili do të jetë fundi i kësaj iniciative akoma është herët të flitet. Por një gjë dihet, minishengeni do të dështojë nëse mbetet pa pjesëmarrjen e Kosovës!

Minishengeni si iniciativë, po të realizohej, do të bëhej motori zhvillimor i rajonit. Zymtësia që sot ka pllakosur rajonin pa dallim, me emigrimet e pafundme dhe pashpresën e jetës së dinjitetshme, do të merrte të tjera ngjyra. Rajoni ynë, për shkak të historisë, e ka të vështirë të ndërtojë union të mirëfilltë, andaj ndërveprimi mbetet akoma një e mundur e domosdoshme dhe për këtë nuk duhet të ndalen liderët. Në kërkim të këtij bashkëveprimi liderët dhe vendet duhet të kuptojnë se në qendër të suksesit qëndron arra e fortë; mosnjohja e Kosovës nga Serbia. Energjitë e para duhet të shterohen në këtë drejtim, në këtë njohje!

Kosova përbën shtrirjen gjeografike që mund të quhet zemra e rajonit i cili po mëton të krijojë hapësirë implementuese për katër liritë shengeniane. Ajo në vetvete është edhe më shumë se vetëm shtrirje gjeografike, është shqiptare dhe si e tillë determinon sjellje jo vetëm respekti, por edhe obligimi të së paku dy faktorëve të tjerë të Shqipërisë politike dhe të Maqedonisë e cila përbëhet nga gati gjysma e popullatës së saj me etni shqiptare dhe lidhje të forta nga familjare e deri etno-sociologjike.

Me shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi dhe Luginë, Kosova ndanë fatin e njëqind vjetëve të fundit më afër se me këdo tjetër. Andaj, Kosova impakton fuqishëm edhe funksionalitetin demokratik dhe rendin kushtetues në Mal të Zi, ku pa votën shqiptare dhe boshnjake shteti rrezikon të bjerë në duart e partive serbe e proserbe. Një zhvillim i tillë në Mal të Zi do ta kthente rajonin në apetite serbe

ku pak do t'i duhej shovinizmit serb të kthehej në fashizëm veprues. Rusia mezi pret zhvillime të tilla. Takimi i Novisadit do të duhej t'u shërbente si mësim të gjashtë vendeve të rajonit. Ngërçi real i atij takimi ishte Kosova. Presidenti Thaçi apo kryeministri Haradinaj nuk mund të udhëtonin atje për shumë arsye, por janë disa që përbëjnë qenësoren e atij mosudhëtimi.

Si e parë ftesa për Kosovën duhej të ishte ftesë për shtetin e Kosovës, ftesë e cila do të garantonte prezantim të barabartë dhe ky prezantim i barabartë do të obligonte impenjim real konform interesave të shtetit të Kosovës si në marrje përgjegjësisë, po ashtu në ofrim shërbimesh.

Si e dytë Kosova nuk është njohur nga Serbia, dhe si e tretë Serbia mban peng akoma mijëra të zhdukur të luftës të cilët i degdisi nëpër frigoriferë e furra në Serbi. Për dëmet e luftës nuk po merremi me to sepse ato një ditë të afërt Serbia edhe do të detyrohet t'i paguajë.

Takimi i Ohrit, nëse Kosova është thirrur në cilësinë e shtetit, përbën gabimin e madh të mospjesëmarrjes sonë. Ne nuk mund të mbetemi jashtë zhvillimeve. Se a do të bëhet Kosova pjesë a jo e këtij minishengeni këtë e vendosin drejtuesit tanë bazuar në ato që ofron e argumenton iniciativa, por se duhej të merrej pjesë këtë nuk e vë fare në dyshim. Tavolinat janë për t'u qartësuar pozicionet dhe Kosova nuk duhet të ketë frikë nga to. Fundja, ne mëtojmë të bëhemi pjesë e gjithë tavolinave ku çështjet kanë të bëjnë me zhvillimet rreth nesh dhe në ne.

Përfundimisht në takimin e Tiranës është bërë gabim që nuk është shkuar! Tirana është shtëpia jonë dhe aty ne jemi shtet në tërësinë e kuptimit shtetësi. Një prezantim i tillë shtetëror në këtë takim rajonal do të kishte impaktin e mëpastajshëm dhe do të reflektonte arsye për gjithë veprimet e mëtutjeshme në vazhden e kësaj nisme. Ky reflektim do të vinte që në takimin e Beogradit kur Serbia do të kishte vështirësi ta ftonte Kosovën në cilësinë e të qenit shtet.

Pra minishengeni nga një vullnet në eter nuk mund të kthehet në një ndërmarrje në terren pikërisht për shkak të mosnjohjes së Kosovës nga Serbia dhe për epiqendrën impaktuese që Kosova bartë në vete qoftë si gjeografi qoftë si etni.

Ashtu sikurse vërshimi i ekonomisë serbe u ndërpre me vënien e taksës edhe minishengeni nuk do mund të shkojë

përtej një fluiditeti informal të kufijve tanë derisa Kosova të mos njihet nga Serbia.

Minishengeni si iniciativë është e mirë, veçanërisht në kohën kur integriteteve evropiane nuk u shihet filli dhe rajoni po e vuan bombën demografike. Zbrazja e rajonit po shkon drejt fatales dhe kjo duhet ndalur me zhvillim i cili nuk vjen pa u bërë interes investimesh për ekonominë e mëdha. Pikërisht minishengeni është një ndër mundësitë gati të vetme përmes së cilës rajoni do të marrë vlerë interesimi të investuesve, por edhe rritë mundësitë e zhvillimit të brendshëm.

Studiues të shumtë mund të shohin me imtësi ashtu sikur shohin mundësitë edhe rreziqet e brendshme. Ato mund të ndikohen nga historia, por edhe nga brishtësia e rajonit. Kjo brishtësi vjen nga çështjet e pazgjidhura. Rajoni pushon në një gjendje lënë pezull. Çështja shqiptare dhe ajo serbe mbeten kryefjala destabilizuese e rajonit. Nga këto dy çështje nuk mund ta gjejmë paqen as boshnjakët, as maqedonasit dhe as malazezët. Bazuar në këtë brishtësi rajonale dhe në zhvillimet e dekadave të fundit për të shkuar te minishengeni së pari do zgjidhur nyja kosovare. Pranimi i shtetit të Kosovës nga Serbia ose bashkimi i Kosovës në Shqipëri. Pa u zgjidhur kjo, rajoni as mund të ketë minishengen, as integritete të brendshme. Mirëkuptimet që kemi sot si kamuflime projektsh kundër njëri-tjetrit e bëjnë minishengenin të porealizueshëm, ndoshta edhe kërcënues!

Sfida minishengen e ka fatin e prerë sikur thamë nga fakti i mosnjohjes së Kosovës nga Serbia. Na mbetet të shohim

dimensionin tjetër reflektues të kësaj nisme me fat të prerë, vetëdijesimin!

Integritet nuk mund e as do të ndodhin ndonjëherë në terma të jopërcaktuar të cilët nuk shprehin tërësi të vetëkontrolluara për të cilat ka përgjegjësi dhe njihet kjo përgjegjësi. Rregulla vendosin identitetet, të thirrurit e ligjshëm dhe ato bëhen norma sjelljeje në përgjegjësi të emëruar. Pra, në paqenësi nuk mund të vësh rregulla. Trajtesa serbe dhe boshnjake për Kosovën është paqenësi dhe si e tillë ajo nuk mund të prodhojë veprim në iniciativë që mëton rregulla sjelljeje. Bazuar në këtë lehtësisht konstatohet se minishengen të mirëfilltë rajonal nuk do të ketë as mund të ketë. Mund të ketë një kryeneçësi pushtetarësh që do ta përdorin autoritetin e tyre për t'i dhunuar marrëdhëniet rajonale. Kjo dhunë e hipotetuar sot, që nesër mund të bëhet realitet kokëboshësh, mund të shndërrohet në projekte zhvillimesh dramatike. Sigurisht, ka në afërsi të rajonit forca të interesuara të cilat duan ta nisnin një cikël të ri lëvizjesh territoriale e që ndihmojnë të fillohet si e pranuar e së drejtës ndërkombëtare pikërisht nga këtu, nga Ballkani ynë, meqë me Kosovën si realitet të ri dhe lëvizjen e kufijve të saj, mund të goditet më lehtë shpërbërja e Bosnjës dhe Maqedonisë. Në vektorizimin e kësaj tendence drejt Krimesë e jo vetëm atje, vetëdijesimi duhet ta bëjë punën e vet dhe në para-minishengen rajonit duhet të punojë në njohjen e Kosovës nga Serbia si instanca e fundit për ta qetësuar rajonin, ndryshe Shqipëria dhe Kosova duhet ta mendojnë me prioritet integritetin e secilës fushë. Them integritetin e

fushave sepse bashkimi i sotëm i Kosovës me Shqipërinë kalon përmes dy rrugëve të mundshme: njëra shkon përmes njohjes serbe për Kosovën dhe karrigia në OKB prej ku do të fitohej e drejta e bashkimit me vullnet dhe tjetra aneksimi i Kosovës nga Shqipëria si e drejtë historike dhe përkatësie që, në fakt, do të sillte zhvillime domino në rajon dhe jo vetëm në rajon, por kjo do të kërkonte një mbyllje sysh nga NATO-ja si garantuese e paqes këtu. Bërjen realitet të së dytës mund ta jetësonte lëvizja e masave, ku populli i të dy anëve të kufirit do të fillonte te padëgjueshmërinë e lëvizjes mbi kufijtë dhe gjithçka tjetër do të bëhej normalitet i vetëm një funksionimi në frymë e materie të gjithçkaje që nënkupton të qenit një shtet i vetëm.

Vetëdijesimi është një ndërmarrje e vështirë. Ai do vetëdijë dhe qëllim. Nëpër qëllime të shpërndara nga stacioni në stacion nuk mund të ndërtohet vetëdijesim. Çështja shqiptare si e tërë është filli i çdo integriteti me të tjerët. Na takon, në harmoni me kohën që jetojmë, t'i çojmë përpara integritetin brenda shqiptare në gjithë realitetet e tyre sot dhe nga kjo t'i mësojmë kahet integruese për proceset në vijim. Vetëm pas kësaj dhe në qartësi të interesave vetjake ne mund të ndërtojmë marrëdhënie të shëndosha integruese në minishengenin e aq nevojshëm për rajonin. Kështu sikur jemi të shpërndarë dhe të papërqendruar në artikullimin e interesit që buron nga çështja jonë parakoha e iniciativave pa edhe e minishengenit do të përplaset e shpërbëhet në statutin e Kosovës si funksionalitet dhe realitet.



SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!

NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS


- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Timmermans: Britania gjithmonë e mirëpritur në BE

BRUKSEL, 26 DHJETOR - Zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Frans Timmermans, ka shkruar një letër dashurie për Britaninë, duke shprehur "dhimbjen e thellë" për largimin e këtij shteti nga Bashkimi Evropian. "Gjithmonë do të jesh e mirëpritur për t'u kthyer", ka thënë ai duke iu referuar Britanisë në të përditshmen britanike, "The Guardian". "Prej kur kam shkruar në shkollë britanike, ju gjithmonë keni qenë pjesë imja. Tani po largoheni dhe kjo më thyen zemrën", thuhet mes tjerash në letër. Britania e Madhe pritet të largohet nga Bashkimi Evropian më 31 janar të vitit 2020.

Ligjvënësit britanikë kanë miratuar planin për largim të kryeministrit, Boris Johnson më 20 dhjetor, vetëm tetë ditë pasi Partia Konservatore ka fituar zgjedhjet e përgjithshme. Kjo situatë do të nxisë një periudhë transitore të negociatave, e cila sipas projektligjit të Johnsonit, siguron se nuk do të zgjasë përtej vitit 2020. Duke pretenduar se Parlamenti Evropian, po ashtu, do t'i përfundojë procedurat, Mbretëria e Bashkuar do të largohet zyrtarisht nga Bashkimi Evropian më 31 janar me marrëveshje dhe më pas do të hyjë në periudhë transitore që do të përfundojë më 31 dhjetor të vitit 2020. Gjatë kësaj periudhe, Britania do të funksionojë në kuadër të Doganave të BE-së dhe tregut të përbashkët, mirëpo do të jetë jashtë institucioneve politike dhe nuk do të ketë anëtarë britanikë në Parlamentin Evropian. Vendimi për largim të Britanisë nga blloku evropian ka ardhur pasi 52 për qind e votuesve kanë votuar për dalje të Britanisë nga BE-ja kundruall 48 për qind që kanë kundërshtuar atë, në referendumin e mbajtur më 2016.



Shkarkimi i presidentit, vazhdon paqartësia mbi gjyqin në Senat

Kritikat e presidentit Donald Trump ndaj ligjvënësve demokratë vijnë në një kohë kur Kongresi vazhdon të jetë i përfshirë nga një situatë ngërçi lidhur me procesin gjyqësor që duhet të zhvillohet në Senat

WASHINGTON, 26 DHJETOR - Presidenti Donald Trump vijon të kritikojë ligjvënësit demokratë lidhur me ngritjen zyrtarisht të akuzave si pjesë e një procesi që synon shkarkimin e tij. Kritikat vijnë në një kohë kur Kongresi vazhdon të jetë i përfshirë nga një situatë ngërçi lidhur me procesin gjyqësor që duhet të zhvillohet në Senat. "E majta radikale, demokratët që s'dinë të bëjnë asgjë thanë se donin ta çonin këtë gjë me shpejtësi në Senat sepse presidenti Trump është kërcënim për Sigurinë Kombëtare. Tani nuk duan të vazhdojnë me shpejtësi, por shumë ngadalë. Gënjeshtarë!", shkruante Trumpi në Twitter, ka njoftuar voa. Në një votim sipas linjave partiake, Dhoma e Përfaqësuesve e kontrolluar nga demokratët miratoi të mërkurën e kaluar ngritjen zyrtarisht të dy akuzave ndaj presidentit Trump, gjë që e

bën atë presidentin e tretë në historinë 243-vjeçare të vendit ndaj të cilit ngrihen akuzat për shkarkim. Trumpi akuzohet për abuzim me detyrën për përfitim politik si dhe pengim të përpjekjeve të Kongresit për të hetuar veprimet e tij. Kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve Nancy Pelosi e ka shtyrë për një afat të pacaktuar dërgimin e akuzave në Senat në mënyrë që të nisë procesi gjyqësor. Ajo ka thënë se nuk do të veprojë derisa Senati të përcaktojë rregullat mbi procesin. Javën e kaluar, udhëheqësi republikan i Senatit Mitch McConnell hodhi poshtë thirrjet e udhëheqësit të demokratëve në Senat Chuck Schumer për të dëgjuar dëshmitë e katër zyrtarëve në Senat, përfshirë ish-këshilltarin e Sigurisë Kombëtare John Bolton si dhe shefin e detyrës të kabinetit në Shtëpinë e Bardhë Mick Mulvaney. Këta zyrtarë nuk kanë



pranuar të dëshmojnë gjatë hetimeve që kreu Dhoma e Përfaqësuesve që çuan në ngritjen e akuzave ndaj presidentit. Megjithatë të hënën McConnell i zbuti tonet dhe tha se repub-

likanët nuk e kanë përjashtuar thirrjen e dëshmitarëve në Senat. Krahas seancave dëgjimore me dëshmitarë kyç Schumer ka kërkuar edhe paraqitjen e ema-

jlave e dokumente të tjera që siç thotë ai "do të hidhnin më shumë dritë në vendimmarrjen e administratës lidhur me ndihmën financiare ushtarake ndaj Ukrainës".

Shanset e Netanjahut për të qëndruar në krye të partisë

Tel Aviv, 26 dhjetor - Kryeministri izraelit Benjamin Netanjahu është përballur të enjten me një sfidë ndërsa partia e tij Likud po zhvillon zgjedhje paraprake, për të vendosur se kush do ta udhëheqë atë drejt zgjedhjeve të treta të përgjithshme në Izrael brenda një viti. Netanjahu vazhdon të jetë popullor mes anëtarëve të partisë së tij dhe pritet ta mbajë pozitën e kryetarit, me gjithë akuzat e ngritura ndaj tij muajin e kaluar. Kundërshtari i hershëm Gideon Saar, e ka paraqitur veten si një

alternativë më e mirë për shanset e formimit të qeverisë. "Ndjej një rizgjim të madh në terren. Njerëzit kuptojnë se sot ka nevojë për ndryshim dhe do Zoti, së bashku do ta bëjmë këtë të mundur sot. Ju falënderoj shumë", tha Gideon Saar, kandidati për kryetar të partisë Likud. Netanjahu ruan popullaritetin mes anëtarëve të partisë Likud dhe pritet ta ruajë pozicionin e kryetarit, me gjithë akuzat e ngritura ndaj tij muajin e kaluar për mashtrim, rryshfet dhe thyerje të besimit në tri raste të

veçanta korrupsioni. Ai i ka mohuar me forcë të gjitha akuzat. Rezultatet e zgjedhjeve brenda partisë priten të shpallen sot (e premte). Ndërsa Netanjahu zhvillonte një aktivitetet elektoral në qytetin Ashkelon një raketë u lëshua nga Rripi i Gazës, dhe ai u detyrua të largohet me shpejtësi nga podiumi. Kryeministri dhe bashkëshortja e tij Sara u futën në një bunker aty pranë dhe ai u rikthye më vonë për të mbaruar fjalimin. Ushtria izraelite konfirmoi se



raketa e nisur nga Gaza u interceptua nga sistemi i mbrojtjes "Kubeja e hekurt".

Ushtria u kundërpërgjigj me sulme ajrore ndaj objekteve të Hamasit në Gaza.

Kim Mehmeti: 'Lulet e egra' të Majlinda Ramës, zëri që presim!

Proza është mjeshtri e të rrëfyerit dhe prodhim i 'punëtorisë' së quajtur imagjinatë, ndërkaq poezia është lulishte dhe pranvera e ndjesive, dhe andaj ajo është si 'ylber' që bart të gjitha ngjyrat e shpirtit. Dhe të paktë janë autorët që, po aq, sa janë mjeshtër të të rrëfyerit, pra, po aq, sa posedojnë begatinë imagjinative, të jenë edhe kopshtar të lulishtes së shpirtit.

Një nga shkrimtarët shqiptarë që, me të njëjtën mjeshtri rrëfen dhe ngjiz shqetësimet shpirtërore është Majlinda Rama, e cila, si mjeshtre e rrëfimit, e shpalos vetveten te romanet 'Perandorët' dhe 'Zonja me të kuqe', ndërkaq si poete, te libri poetik 'Lulet e egra'.

Libri poetik 'Lulet e egra' shpërfaq një shpirt të tendosur krijues, si telat e violinës, të cilët, po aq sa prodhojnë tinguj të këndshëm, lëshojnë edhe zëra vajtues. Pra poezitë e këtij libri janë lumturidhembje të shkruara në një, por jo edhe pakënaqësi nga jeta, as atëherë kur je 'hënë e atij që nuk të ka dashur kurrë'.

Thuajse të gjitha poezitë e librit "Lulet e egra" kanë një të përbashkët: janë të ardhura nga përtej shqetësimeve shpirtërore. Dhe të ardhura nga ajo largësi,

ato nuk ka si mos jenë të begata me vizione poetike, në epiqendrën e të cilave qëndron universi njeri dhe njeriu vetë, si krijesë që ëndërron vetveten, siç do donte ta donin e të dashuronte. Poezitë e Majlinda Ramës janë si fillad i gjatëpritur, i cili, me freskinë e vet, tregon se ka ardhur krijuesja që zë vend të rëndësishëm në bibliotekën tonë kombëtare. Ato janë edhe tregues si ndërlidhet vargu në një harmoni të plotë edhe atëherë kur nga brendia e tij dëgjohej klithma e dashurisë së munguar.

Në librin poetik 'Lulet e egra' ka disa poezi të përmasave antologjike, përfshi edhe atë me titullin 'Dy gjysmat', ku ecja drejt vetvetes dhe sa më larg asaj që, tjetër duam të jemi, përbën një udhëtim përplot 'ngjyra që ta puthin shikimin'. Ngjyra nga të



cilat Majlinda Rama e pikturon shqetësimin e saj si dhe kërkesën: "...harroji këto lot/ ne qeshëm sa deshëm e sa deshëm qamë/ rrugëve u endëm si dy Don Kishotë".

Në fund të librit "Lulet e egra" është poezia me titull "Lulet e bardha" për të cilën kritiku ynë letrar, Ali Aliu, konstaton se, vargjet e saj janë 'guaskë e mbyllur, e padepërtueshme'. Madje, jo

vetëm kjo poezi, por edhe shumë të tjera nga kjo përmbledhje poetike, janë tregues se vetë njeriu është në të vërtetë si guaskë e mbyllur, e cila jo rrallë herë, edhe vdes pa u hapur fare dhe pa e parë askush margaritarin në të.

E në ndërkohë duhet shtuar se 'Lulet e egra' të Majlinda Ramës janë shumëçka nga pak: edhe përfytyrim i brendisë së

guaskave të mbyllura, edhe zëri që presim, zëri që duhet të na kumtojë të vërtetën se, ne nuk jemi, as atë që jetojmë, as atë që ëndërrojmë, por ai që kalon përmes tyre, ashtu siç ecet nëpër poezinë e mrekullueshme 'Dy gjysmat'. Poezi që është në ballë të diademës së veçantë poetike, me të cilën Majlinda Rama e begaton thesarin poetik të shqipes. /Exlibris

"Mjerimi i shqiptarëve ka qenë në tërë kohërat kapja pas individëve dhe jo pas ideve"

Faik Konica mbetet një intelektual i papërsëritshëm edhe në ditët e sotme. Një njeri mendjendritur jo vetëm si politikan por edhe si publicist e shkrimtar që pasuroj mendimin letrar shqiptar.

Disa prej shprehjeve më të bukura të Faik Konicës:

- Në qoftë se Shqipëria do të vdiste ndonjëherë, atëherë në epitafin e saj do të duhej të shkruhej: "Shqipëria lindi nga Zoti, shpëtoi nga rastësia, vdiq nga politikanët."
- "Sa lehtë përdorë njeriu fjalë të mëdha për të fshehur nën 'to intriga e për të shfrytëzuar zemërimet të veçanta."
- "Njerëzit e paditur, në shumicë, rojnë më tepër se të diturit, se këtyre u punon nat' e ditë mëndja e ashtu u priset më shpejt organizimi."
- Instinkti kombëtar është konkluzioni që një popull nxjerr nga shumë shekuj përvojë. Ky instinkt nuk të gabon asnjëherë.
- Rinia është e çiltër dhe çiltërsia është armiku i natyrshëm i sharlatanëve.
- Nuk mund të lexohet nëpër rreshta ajo çka nuk ekziston.
- Pa dyshim, çdo parti ka të drejtën, madje dhe detyrën të shtojë radhët e veta në dem të atyre që i kundërvihen.
- Dallimi në kulturë shpjegon dal-

limin në mendime.

- Rinia është në sytë e injorantëve kërcënim për të ardhmen; por është edhe është rrezik për të tashmen, sepse rinia është e çiltër, ndërkohë që dhe çiltërsia është armiku i natyrshëm i sharlatanëve.
- Shumica e atyre që kanë marrë mbi vete misionin modest "të ndriçojnë opinionin publik" as që kanë ndjesinë më elementare ta nisin fillimisht nga vetvetja për t'u mirëinformuar. Në përdorim mënyra hulumtimi të cilat, sikur të zbatoheshin në çdo shkencë, do bënin për të qeshur edhe një nxënës shkolle.
- Nuk ka despotizëm më të keq se sa njëfarë idealizmi dogmatik, që përbuz si përvojën, si faktet dhe gjithçka tjetër që prish simetrinë e thjeshtë të koncepteve a priori.
- Njeriu fillimisht i sheh gjërat ashtu siç janë, dhe më pas u jep pamjen e asaj çka ai do dëshironte të ishin.
- Fisnikëria dhe thjeshtësia mund të jenë cilësi kudo gjetkë, kurse në poezi janë antipasta të dëmshme.
- Çka i kërkohet poetit, poetit të vërtetë, është të shkaktojë një dridhmë të re, të flasë një gjuhë që të tjerë nuk e kanë folur, të ngacmojë ndijime që të tjerë nuk i kanë.
- Një i mbushur me mllëf e mëri, në mendjen e tij anemike, rrokullis mendime të tmerrshme.



- Politika e vërtetë qëndron në kapjen e drejtimit të një evolucioni të caktuar dhe në përpjekjen për të ndihmuar në përsheptimin e fundit të tij.
- Një shkrimtar duhet gjykuar më shumë nga cilësia se sa nga sasia.
- Aq lehtë kujtoni se ëndrrat e kafeneve bëhen punë? Në jini aq besnikë te forca juaj, ngrihuni pra, se shqiptarët ju presin!
- Shqiptarët janë një komb që i pëlqen të lëvdojë veten. Si thonë gojë-rumbullët tanë, kombi shqiptar është i pari nga mendja, nga të sjellurit e nga trimëria. Mua më duket se një njeri që i ka trutë në vend nuk duhet të flasë në atë mënyrë. Po të ishte ashtu shqiptarët do të kishin dalë me kohë nga dita e zezë ku ndodhen.
- Cilësitë që zakonisht shoqërojnë pafajësinë janë natyrshmëria, shpërfillja dhe butësia.
- Ashtu kuptova se në të vërtetë

kisha arritur në Shqipëri, një vend i bekuar me një mijë bukurira, po i shkelur nga një turmë, e cila ushqen një urrejtje kundër bukurisë.

- Trimëria e shqiptarit nuk është e artë, është e teneqenjtë. Me fjalë të tjera, trimëria e shqiptarit, sado e madhe në vete, është e vogël në shkaqet që e ndezin. Për një keq të grabitur, për një fjalë të shtrembër, e shumë herë pa ditur as vetë për se, shqiptarët marrin armët, hidhen, vriten.
- Të verbrit do të mbeten të verbër in saecula saeculorum (gjë në fund të botës); edhe sikur t'u shtini persona në sy, ata prapë nuk do shohin kurrëgjë.
- Kush jeton me fjalë dhe përkundet me ninulla fjalësh, s'ka pse ankohet e të na lëshojë britmat e veta të zakonta prej palloi.
- Historia na mëson se gjithë ndryshimet politike kanë pasur

përherë këta dy faktorë: emigrantët dhe një elitë të vogël, e lindur apo intelektuale, brenda vendit.

- Njeriu fillimisht i sheh gjërat ashtu siç janë, dhe më pas u jep pamjen e asaj çka ai do dëshironte të ishin.
- Drejtësia i takon fushës së ëndrrave; vetëm forca mbisundon.
- Koha kur rrojmë është koha e reklamës, dhe nuk duhet të çuditemi kur shohim mediokritetet e vëndit t'onë të hidhen përpara, dhe përpara, dhe përpara, duke mos bërë vënt përveç për shokë në shkallë (të caktuar) mëndore të tyre.
- Shumica e atyre që kanë marrë mbi vete misionin modest "të ndriçojnë opinionin publik" as që kanë ndjesinë më elementare ta nisin fillimisht nga vetvetja për t'u mirinformuar. Venë e vënë në përdorim mënyra hulumtimi të cilat, sikur të zbatoheshin në çdo shkencë, do bënin për të qeshur edhe një nxënës shkolle.
- Nuk mundena me pushue së foluni kundra loinive (politikave) qi duen me e tretë e me e përpi kët komb të dashtun.
- Populli shqiptar ka disa veti shumë të mira... por një bandë maskarenjsh dhe dalaverexhinjsh kanë zënë të gjitha pozitat kyçe në politikën e vëndit dhe është fare e pamundur t'i shkulësh.

/KultPlus



MARIO VARGAS LLOSA:

Shkrimtari, po ashtu si edhe pushteti, nuk është i detyruar të veprojë gjithmonë drejt

Keni përsëritur shpesh se letërsia e mirë nuk e mbështet kurrë të keqen, sidomos, ajo nuk duhet të bëhet palë me shtypësit dhe diktatorët. Mos do të thotë kjo se shkrimtari duhet të ketë parime morale të kulluara?

Të jem i ndershëm, unë nuk jam përkrahës i këtij pozicioni. Paralele të tilla mund të na shpien shumë larg. Përzjerja e letërsisë me moralin është një çështje tepër e rrezikshme. Nëse fillojmë të gjykojmë nga pikëpamja e moralit, i bie ta ndajmë të gjithë letërsinë në të mirë dhe në të keqe. Por kjo është rrënjësisht e gabuar, sepse një vepër madhështore mund të mbështesë çfarëdo pozicionesh, ndërkohë që mund të jetë origjinale dhe e çmuar nga pikëpamja e kulturës.

Për shembull, Lui-Ferdinand Selin - një shkrimtar shumë i mirë francez - në pikëpamje të moralit, të flasim butë, nuk ka shkëlqyer: Ai ka qenë një makth i vërtetë: urrente hebrenjtë, mbështeste fashistët, ishte racist. Nga ana tjetër, Selini është një shkrimtar shumë original, që ka krijuar jo pak vepra të rëndësishme. Të paktën, dy nga romanet e tij mund t'i quash pa mëdyshje, të mëdhenj - këto janë "Vdekje me kredi" dhe natyrisht, "Udhëtim në fund të natës". Një shembull tjetër jo me më pak interes - ky është Knut Hamsun, një shkrimtar edhe më i shquar, për të cilin gjithashtu është shumë e vështirë të thuash diçka të mirë nga pikëpamja e preferencave të tij: të gjithë e dinë që ai

simpatizonte Hitlerin. Prandaj ejani e të mos e ngatërrojmë pra letërsinë dhe moralin.

A duhet që shkrimtari bashkëkohor të jetë në opozitë me pushtetin, i cili merr vendime të dyshimta politike?

Kryesorja për mua është liria. Shkrimtari, po ashtu si edhe pushteti, nuk është i detyruar që kurdoherë të veprojë drejt. Secili ka të drejtë të gabojë, në fund të fundit. Por ai duhet të ketë mundësinë të shprehet lirisht. Vetëm në këtë rast ato vlera, që ai përçon, do të perceptohen në mënyrë adekuate nga një shoqëri e lirë: dikush do ta mbështesë, dikush, natyrisht, do ta kritikojë. Por shkrimtari duhet të ketë domosdoshmërisht

mundësinë për të shprehur mendimet e tij, ndjenjat dhe emocionet, pa i bërë qejfin asnjë instance të lartë. Më kryesorja, të mos ketë kurrfarë kufizimi.

Në vlerësimin e Kazuo Ishiguro, Komiteti i Nobelit theksoi me këtë rast, që ne jetojmë në një botë multikulturore, multigjuhësore. Edhe për ju është kjo përvojë: jeni lindur në Peru, keni jetuar në Spanjë, në Francë, në Britaninë e Madhe. Si ka ndikuar kjo përvojë në krijimtarinë tuaj?

Përvoja më e rëndësishme, që mund të ketë një shkrimtar, e gjitha merret në fëmijëri dhe rini. Pikërisht, me këtë lëndë të parë, me këtë bazament punon shkrimtari, duke e pasuruar me fantazinë e tij. Natyrisht, të gjitha

vendet, ku kam qenë, të gjithë librat që kam lexuar dhe gjithë njerëzit që kam takuar, gjithashtu kanë ndikim në atë çfarë bëj. Por, përvoja ime më kryesore, përvoja që më ka formësuar - është rinia ime, që kam kaluar në Peru. Kjo ka ndikuar njëtrajtshëm në individualitetin tim, në atë se si e kuptoj letërsinë dhe në atë se si shkruaj.

Si ju duket, cili është roli i shkrimtarit në Amerikën Latine dhe në Europë? A ka dallime parimore në konceptim?

Roli i shkrimtarit kudo është i njëjtë - si në Rusi, si në Peru apo si në Kinë! Mjedisi shoqëror dhe veçoritë politike, natyrisht, sipas saj ndikon mbi këtë rol, por letërsia nuk mundet t'i përshtatet

Realizmi kurdoherë më ka interesuar më shumë se fantazia. Ai imazh i botës, që vizatoj, është afër lexuesit, sepse nuk dallohet prej përvojës së tij personale. Përveç kësaj, realistët magjikë nuk i ngajnë njeri tjetrit: Borhes dallohet nga Kortasari, Markez nga Rulfo. Për më tepër kjo etiketa "realizmi magjik", nuk i ndihmon aspak lexuesit që të kuptojë poetikën e këtyre autorëve. Por, natyrisht, në Amerikën Latine fillesa fantastike ka një rëndësi të madhe për të gjithë autorët. Dhe kjo është logjike, sepse Amerika Latine është një vend që bashkon në vetvete një masë gjuhësh.

Vetëm letërsia e mirë mund të formojë një qytetar të mirë që mendon lirish, i pavarur, me një fjalë, që vështirë se mund ta manipulojnë me ndihmën e propagandës.

Heronjtë tuaj shpesh shtegtojnë nga njeri roman në tjetrin. Si e merrni këtë vendim, cilës figurë i drejtoheni përsëri?

Oh, edhe vetë nuk e kam zgjidhur këtë gjë. Nuk mund ta them me siguri përse një hero kthehet dhe tjetri jo. Unë kam disa personazhe, të cilët periodikisht vijnë tek unë dhe futen vetë te romani i ri. Njeri prej tyre, për shembull Lituma, ai për herë të parë u shfaq në jetën time shumë kohë më parë, kur unë isha djalos dhe sapo kisha filluar veprat e mia të para. Në këtë rast shumica e personazheve të mi thjesht zhduken, duke u

shfaqur vetëm një herë. Kurse Lituma mbetet. Mbase, problemi është se unë nuk e kam shfrytëzuar gjithë potencialin e mundshëm që gjendet tek ai, mbase, ai thjesht paraqet imazhin e tij universal, i cili mund të bëhet pjesë e veprave të mia të shumta. Ky është proces irracional, nuk mund ta shpjegoj në mënyrë logjike.

Në esenë "Civilizimi i spektaklit" ju përshkruani një botë ku zbavitja është bërë vlera kryesore e kulturës. A duhet që letërsia t'i bashkohet kësaj tendence?

Ky proces veçse është rënduar. Sot zbavitja është bërë i vetmi qëllim i artit vizual, ashtu edhe i letërsisë. Unë e kuptoj që autorët në këtë mënyrë përpiqen të arrijnë sa më shumë njerëz, por kjo sjell një thjeshtëzim të tmerrshëm të gjuhës, mendimit, formës së veprës. Ajo dëmton jo vetëm letërsinë, por edhe shoqërinë në tërësi. Tani ka jo pak mendimtarë, të cilët janë të bindur që kthim në zbavitje - është një rrugë shumë e mirë për shoqërinë e sotme. Për shembull, filozofi frëng Gilles Lipovetsky është i sigurt që më në fund kemi fituar një kulturë të vërtetë demokratike, e cila është e kuptueshme për cilindo, kurse ajo elitare si fenomen i përket të kaluarës. Por unë nuk ndaj aspak këtë pikë pamje. Nëse letërsia është kthyer vetëm në zbavitje, atëherë ajo pashmangshmërisht do të degjenerojë, thjesht do të bëhet e painteres. Nëse best-




Kryesorja për mua është liria. Shkrimtari, po ashtu si edhe pushteti, nuk është i detyruar që kurdoherë të veprojë drejt. Secili ka të drejtë të gabojë, në fund të fundit. Por ai duhet të ketë mundësinë të shprehet lirish. Vetëm në këtë rast ato vlera, që ai përçon, do të perceptohen në mënyrë adekuate nga një shoqëri e lirë: dikush do ta mbështesë, dikush, natyrisht, do ta kritikojë

plotësisht atyre kushteve ku ajo krijohet. Shkrimtari i mirë gjithmonë u drejtohet çështjeve universale. Pikërisht për këtë veprat e shquara janë të kuptueshme për lexuesit pavarësisht prejardhjes dhe sfondit kulturor. Në Amerikën Latine ne mund të lexojmë lehtësisht Tolstoin, Dostojevskin, Çehovin, t'i kuptojmë dhe të marrim kënaqësi nga krijimtaria e tyre, sikundër nga ana e tyre, në Rusi e lexojnë dhe e kuptojnë Borhesin, Markezin dhe Kortasarin. Letërsia është universale. Është pikërisht kjo që e dallon nga folklori dhe moda, e cila shpesh është e lidhur fort me traditën vendore. Letërsinë mund ta gjiykojmë edhe nga pikëpamja rajonale, po ashtu. Nëse ajo nuk i shtron vetes pyetje universale, do të thotë që pushon së ekzistuari.

Në një intervistë keni thënë, që, pasi lexuat Foberin, vendosët të bëheshit ai shkrimtar që përshkruan ngjarje reale. Ndërkohë, shpesh ju lidhin me traditën e realizmit magjik. Si bashkëjetojnë te proza juaj këto dy tendenca?

Ideja e realizmit magjik nuk mund të thithë në vetvete gjithë atë pasuri të Amerikës Latine. Vetëkuptohet, ne kemi jo pak shkrimtarë, që përdorin trope fantastike në veprat e tyre, si tek Markez dhe Kortasar dhe Rulfo. Por ka edhe autorë të tjerë, që shumë më tepër tërhiqen nga realizmi. Unë jam njeri prej tyre.



sellerat do të zënë vendin e letërsisë cilësore, kjo do të jetë katastrofë për të gjithë kulturën.

E ndiqni pop-kulturën? A ka fenomene që ju interesojnë?

Natyrisht, më intereson kultura masive. Nëse dëshironi të zbaviteni, ajo u demonstroi një masë formatësh të larmishme, të lehtë dhe tërheqës për publikun. Pjesa më e madhe e filmave dhe serialeve është bërë shumë cilësore dhe e kuptueshme. Por unë nuk do ta përzieja kulturën masive me atë që quhet arti i lartë. Kjo s'është aspak e njëjta gjë. Leximi i njëfarë bestselleri popullor dhe leximi i Prustit apo Xhoisit kërkon përpjekje krejt të ndryshme.

Nëse letërsia është kthyer vetëm në zbavitje, atëherë ajo pashmangshmërisht do të degjenerojë, thjesht do të bëhet e painteres. Nëse bestsellerat do të zënë vendin e letërsisë cilësore, kjo do të jetë katastrofë për të gjithë kulturën.

Mund të kënaqeni me "Ulksin", apo, të themi, me veprat e Folknerit, vetëm nëse jeni i gatshëm të përmbliidhni gjithë njohuritë dhe përfytyrimet tuaja.

Vetëm kështu ju mund të kuptoni thellësinë dhe shumëfaqshmërinë e këtyre veprave. Po, seriale të tilla, si përshembull Homeland (atdheu), kjo është një zbavitje e mrekullueshme. Unë mundem të kënaqem gjithashtu prej tyre, por ka një dallim midis nivelit të ideve dhe cilësisë së realizimit, të cilat na i ve përpara arti i lartë dhe kultura e konsumit masiv.

Çfarë roli luajnë sot librat? A do t'ia dalin ato të ruajnë pozitën e tyre?

Ndikimi i librave të mirë është kolosal. Ata na japin mundësinë të ndjehemi se çfarë pasurie fsheh gjuha jonë amtare dhe ajo e huaj. Na ndihmojnë të shprehim mendimet tona shumë më saktë. Përveç kësaj, letërsia e madhe zhvillon ndjeshmërinë tonë. Ne fillojmë të kuptojmë më mirë se ç'ndodh në botën rreth nesh, fitojmë një qasje kritike ndaj realitetit. Vetëm letërsia e mirë mund të formojë një qytetar të mirë që mendon lirish, i pavarur, me një fjalë, që vështirë se mund ta manipulojnë me ndihmën e propagandës. /Exlibris/Përktheu: B. Hudhri

E jashtëzakonshme

Gorilla e kopshtit zoologjik habit me dorën si prej njeriu

Drejtimesit e një kopshti zoologjik në Atlanta të ShBA-së festuan gjashtëvjetorin e lindjes së gorillës së tyre, të quajtur Anaka, por fotografitë që shpërndanë i bënë shumë njerëz të habiten. Ndjekësit në rrjete sociale vunë re se po ta zmadhoje pamjen, gishti i gorillës dukej shumë i ngjashëm me atë të një njeriu. Ngjyra prej mishi



njeriu, që i shfaqet vetëm te njëra dorë, shkaktohet për shkak të mungesës së një pigmenti.

FOTO E DITES



Një grua në Izrael shihet duke i rregulluar enët me ushqim. /Reuters/

E rrallë

Zbulohet saktë kur u zhdukën paraardhësit e parë të largët të njeriut të sotëm

Homo-erectus i fundit u zhduk rreth 110 000 vjet më parë në ishullin Java në Indonezi, sipas një studimi të botuar së fundmi në revistën 'Nature'. "Për herë të parë ne me siguri kemi përcaktuar kur saktësisht Homo-erectus, një nga paraardhësit tanë më të rëndësishëm, u zhduk", ka thënë për "AFP", Kira Westaway nga Universiteti



Macquarie, Australi, bashkautore e studimit. Mbetjet fosile të Homo-erectus, 12 kafka dhe dy kocka këmbësh u gjetën në vitet 1930 në Ngandong, në brigjet e lumit Solo, Java, Indonezi, por mosha e tyre nuk mund të përcaktohej me saktësi. Ekzistenca e Homo-erectus vlerësohet rreth një milion e gjysmë vjet.

BARSOLETA E DITËS



Kryeministri e viziton një çerdhe. I sheh fëmijët duke luajtur dhe i thotë ministrit të Financave:
- Ndajini 5 000 euro për përmirësimin e kushteve të çerdes.
Ministri i ndan.
Shkojnë ndërkohë ta vizitojnë një burg. Kryeministri i sheh të burgosurit dhe i thotë ministrit të Financave:

- Ndani 500 000 euro nga buxheti për përmirësimin e kushteve për të burgosurit.
Ministri i Financave: - Pse 5 000 euro për fëmijët e për të burgosurit 500 000?
Kryeministri: - Mendoni se pas zgjedhjeve do të na dërgojnë në çerdhe?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Të gjitha projektet e reja, edhe dokumente


zyrtare, kanë për t'u realizuar. Ndonjë martesë, birësim apo marrëdhënie biznesi do të fillojë të ketë qëndrueshmëri dhe stabilitet.



DEMI

Është koha për të bërë një plan shumë të

mirë që të hiqni çdo stres që ju është akumuluar prej kohësh.



BINJAKËT

Një romancë e re dhe e nxehtë

mund të vijë në jetën tuaj, por mbani mend se romanca vjen në të gjitha format dhe nuk ka gjithnjë lidhje me seksin dhe zhveshjen.



GAFORRJA

Sa më gjatë të mbroini atë që mendoni

aq më bindës do të jeni. Prandaj shmangni bërjen e ndonjë kompromisi tani.



LUANI

Në jetën tuaj personale ju po hyni

në një fazë të qëndrueshme harmonie. Të gjithë në grupin e miqve tuaj duket se janë në sinkronizëm.



VIRGJËRESHA

Ju po hyni në një fazë jashtëza-

konisht interesante. Keni kaq mundësi para jush sa do ta keni shumë të vështirë të zgjidhni.



PESHORJA

Anëtarët e rrethit tuaj të brendshëm po

vdesin ta planifikojnë kohën me ju. Do të përjetoni disa të qeshura të mëdha dhe do t'i forconi më shumë disa lidhje shoqërore.



AKREPI

Pavarësisht përpjekjeve tuaja më të mira, nuk po

arrini përgjigjet që dëshironi, as në jetën tuaj të punës, as në një situatë romantike.



SHIGJETARI

Ju po argëtoni njerëz të ndryshëm

ditën e sotme sepse do të keni një humor shumë të madh. Për këtë gjë miqtë tuaj do t'ju adhurojnë.



BRICJAPI

Ecni përpara dhe mos lejoni që

dikush ose ndonjë gjë t'ju frikësojë. Mundohuni të realizoni të paktën katër biseda sot (mundësisht me të panjohur).



UJORI

Ju nuk duhet të bëni asgjë të rrezik-

shme ose të paligjshme, natyrisht, por jepni vetes dritën jeshile për ta tepruar pak me ushqimet e shijshme.



PESHQIT

Sot duhet të bëni më shumë përpjekje

për të gjetur një ekuilibër në jetën tuaj. Pyetni miqtë se çfarë do të bënin nëse do të ishin në vendin tuaj.

Miley Cyrus dhe Liam Hemsworth arrijnë marrëveshjen e divorcit një vit pas dasmës



Zyrtarisht gjithçka po mbaron mes Miley Cyrus dhe Liam Hemsworth. Gati një vit pas dasmës së tyre të papritur, "ET" ka mësuar se çifti ka përfunduar detajet e fundit të marrëveshjes së divorcit. Dokumentet ligjore u paraqitën të hënën dhe të dyja palët kanë rënë dakord për

kushtet. Këngëtari dhe aktorja kishin nënshkruar një marrëveshje paramartesorë ndaj çështja e ndarjes së pasurisë nuk ishte problem. Ndërsa u ra dakord që Miley do t'i mbajë kafshët. Sapo t'i paraqesin dokumentet, do të duhet gjashtë muaj që divorci të bëhet i formës së prerë.

Kim Kardashian i bën dhuratë 65 625 dollarë vajzës gjashtëvjeçare



North West ka marrë një dhuratë 65 625 dollarësh nga prindërit Kim Kardashian dhe Kanye West. Çifti i dhuroi vajzës gjashtëvjeçare xhakëtën e Michael Jacksonit që e fituan në një ankand pikërisht për t'ia dhënë Northit. Xhaketa u vesh nga ylli i popit në festën e 65-vjetorit të lindjes së Elizabeth Taylor

në vitin 1977 dhe u shit për 65 625 dollarë në tetor. "Kanye dhe unë i dhamë Northit këtë xhakëtë. Është xhaketa e Michael Jacksonit që veshi me Elizabeth Taylor", ka ndarë lajmin Kimi me miliona fansat në mediat sociale. "Ajo është tifoze e madhe e Michael Jacksonit dhe ne e dinim që do t'i pëlqente", ka shkruar Kimi.



Jennifer Lopezi edhe veshjet e fitnessit i ka në frymën e Krishtlindjeve

Jennifer Lopezi duket se edhe rrobat e ushtrimeve ka zgjedhur t'i ketë në frymën e festës së Krishtlindjeve. Këngëtarja e "Dinero" dukej shumë festive derisa ka dalë nga fitnessi pasi

kishte përfunduar ushtrimet e veshur me një palë streçe ngjyrë të kuqe të ndezur që shkëlqenin dhe sutjena sportive të së njëjtës ngjyrë. Ajo e kishte kompletuar pamjen e saj me syze.

Krishtlindjet e Nick dhe Priyankas



Nick Jonas dhe Priyanka Chopra janë duke u dhënë fansave disa prej informatave se si i kaluan së bashku Krishtlindjet për herë të dytë si çift i martuar. Këngëtari 27-vjeçar dhe aktorja 37-vjeçare postuan fotografi nga festimet e

tyre të së mërkurës. "Gëzuar Krishtlindjet nga ne për ju", ka shkruar Nick në imazhin e "Instagram"-it. Ndërkaq në fotografitë e tyre ku shihen mbi motorski, ai shkroi: "S'ka asgjë më të bukur sesa ta shoh atë duke buzëqeshur".

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Sermaxhaj: Challandes nuk e bëri zgjedhjen e lojtarëve të Superligës

Trajneri dhe analisti i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka hedhur dyshime se trajneri Bernard Challandes i ka ftuar lojtarët e Superligës, pasi strategu zviceran e ka përcjellë shumë pak kampionatin vendor. "Nuk mund të them saktë, por nuk besoj se Challandes ka ndikuar në zgjedhjen e këtyre lojtarëve sepse ai shumë pak e ka përcjellë ligën tonë", ka thënë Sermaxhaj



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, e ka bërë publike listën e futbollistëve për ndeshjen miqësore kundër Suedisë më 12 janar në Doha të Katarit. Ndryshe nga e kaluara, për këtë ndeshje trajneri Challandes ka ftuar 13 futbollistë që angazhohen në klubet e IPKO Superligës së Kosovës në futboll.

Analisti dhe trajneri i futbollit, Genc Sermaxhaj, ka thënë për gazetë se beson pak në atë se trajneri zviceran i zgjodhi këta futbollistë për faktin se ai shumë pak e ka përcjellë elitën e futbollit të Kosovës. "Nuk mund të them saktë, por nuk besoj se Challandes ka ndikuar në zgjedhjen e këtyre lojtarëve sepse ai

shumë pak e ka përcjellë ligën tonë", ka thënë Sermaxhaj.

Në lidhje me përzgjedhjen e futbollistëve, Genc Sermaxhaj ka deklaruar se disa futbollistë janë ftuar për shkak se janë të rinj. Ai beson se është dashur të ftohen edhe lojtarët e tjerë që kanë qenë pjesë e formacionit të vitit në Superligë. "Mendoj se moshë e një lojtari ka pak rëndësi nëse ai luan në nivelin e kërkuar. Përzgjedhësit ndoshta e kanë marrë si ide që të ftohen më shumë lojtarët më të ri për një mundësi për të ardhmen sesa lojtarët në moshë. Mendoj se është dashur të ftohen lojtarët e përzgjedhur si më të mirët e këtij viti të Superligës, që t'u jepet mundësia ta veshin fanellën e Kosovës dhe ta ndiejnë edhe ata ndjenjën e futbollitit përfaqësues, ngase në të ardhmen nuk mund ta kenë këtë mundësi", ka deklaruar Sermaxhaj. "Ata

që kanë bërë përzgjedhjen e kësaj liste duhet të dalin dhe të tregojnë se për çfarë arsyeje janë ftuar këta apo ata lojtarë dhe normalisht që duhet dhënë përgjegjësi për ndonjë dështim eventual si shenjë arsyetimi për lojtarët e moshuar dhe djersën e tyre në ligën e Kosovës të cilët janë dëshmuar me vite", ka përfunduar Sermaxhaj.

Në Përfaqësuese nuk është ftuar futbollisti më i mirë i Superligës dhe golashënuesi i vitit, Kastriot Rexha, kurse mungojnë edhe Arbër Prekazi, Përparim Islami, Visar Berisha, Mendurim Hoti dhe Xhevdet Shabani. Nga elita e futbollit të Kosovës janë ftuar Visar Bekaj, Florian Smakiqi, Leotrim Bekteshi, Lapidar Lladrovci, Armend Thaqi, Edison Kqiku, Albert Dabiqaj, Arbër Hoxha, Albin Krasniqi, Valimr Veliu, Jetmir Topalli, Blend Baftiu dhe Arb Manaj.

SHKURT

Arsenali ofron Xhakën për Ndidin

Trajneri i ri i Arsenalit, Mikel Arteta, kërkon përforsime të menjëhershme në janar, ndërsa ka gati edhe listën e largimeve. Në mes të emrave është Granit Xhaka. Mesfushori me origjinë shqiptare ka oferta të shumta në Evropë, por klubi mësohet se dëshiron ta përdorë për të arritur te një emër tjetër. Wilfred Ndidi i Leicesterit ka impresionuar topçinjtë të cilët do të bëjnë në janar një ofertë të rëndësishme prej 40 milionë paundësh dhe kartonin e Granit Xhakës për ta bindur Leicesterin që ta lërë të lirë.

Lazio mendon ta huazojë Berishën

Aventurës së yllit të Përfaqësueses së Kosovës, Valon Berisha, te Lazio po i vjen fundi. Drejtori sportiv i Lazios, Igli Tare, po përpqet t'i gjejë një sistemim Berishës në afatin kalimtar të janarit. Mesfushori 26-vjeçar i ardhur nga Salzburgu në verën e vitit 2018 te Lazio për rreth tetë milionë euro, është i gatshëm të largohet edhe në formë huazimi, pasi dëshiron të jetë në formë sa më të mirë për impenjimet e ardhshme me Kosovën në fazën e "play-off"-it të Ligës së Kombeve që do të zhvillohet në mars të 2019-s.

KB Rahoveci liron tre basketbollistë

KB Rahoveci ka liruar tre basketbollistë amerikanë pas përfundimit të sezonit vjeshtor. Bëhet fjalë për Christian Bradford, Javis Howard dhe Josh Davis. Ky klub ka bërë me dije se gjatë ditëve të ardhshme do të bëhen transferime të reja për sezonin pranveror. "Në kuadër të diskutimeve dhe analizave të pjesës së parë të sezonit dhe ndryshimeve që po merren për vazhdimin e kampionatit, KB Rahoveci me marrëveshje ka liruar nga angazhimi tre basketbollistë amerikanë, Christian Bradford, Javis Howard dhe Josh Davis. Bordi i falënderon për angazhimin dhe i dëshiron suksese në të ardhmen. Ditët e ardhshme, po ashtu, do të ketë konfirmim për transferime të reja dhe përgatitjet për vazhdimin e sezonit kanë vazhduar pa pushim. Për të gjitha detajet do të informoheni me kohë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Rahovecit.

Distria Krasniqi me 'ipponin' e dytë më të mirë në vitin 2019

PRISHTINË, 25 DHJETOR - Xhudistja e Kosovës, Distria Krasniqi, e ka mbyllur me shumë sukses vitin 2019, me fitore spektakolare. Federata Ndërkombëtare e Xhudos - IJF ka bërë përmbledhjen e

top 20 fitoreve të xhudistëve me "ippon". Krasniqi është përzgjedhur me ipponin e dytë më të mirë në vitin 2019, të cilin e kishte shënuar në Tokio, aty ku edhe rrëmbeu medaljen e bronzit në

Botërorin e seniorëve. Kujtojmë se Distria Krasniqi është xhudistja kosovare e ranguar më së larti në ranglistën botërore. Ajo është e para në ranglistën olimpikë në kategorinë e saj, atë deri 48

kilogramë, e vitin 2019 e mbylli me të artën në Mastersin e mbajtur në Kinë, kurse kishte fituar të argjenditën në Grand Prix e Budapestit dhe të artën në Antalya.



Arteta: Xhakën e doja edhe te City

Londër, 26 dhjetor - Trajneri i ri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka deklaruar admirimin e tij për mesfushorin shqiptar Granit Xhaka, duke zbuluar se ai ishte i interesuar ta sillte në

Manchester City kur nisi punën si asistent i Pep Guardiolas. Në këtë mënyrë trajneri spanjoll i ka dhënë shpresë mesfushorit shqiptar se ai mund të ketë një të

ardhme në klubin e Arsenalit. "Si lojtar, kur unë shkova nga Arsenalin në City për ta filluar stërvitjen dhe ne po shikonim në atë pozicion, ai ishte një nga lojtarët në listën time. Kjo

është se më pëlqeu shumë", ka thënë Arteta për "The Telegraph". Xhaka ishte titullar në ndeshjen e parë të Artetës si trajner, në ndeshjen kundër AFC Bournemouth.



KOK-u dhe ShGSK-ja, konferencë rreth pasqyrimit të aktiviteteve sportive në media

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Komiteti Olimpik i Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve Sportivë të Kosovës ka organizuar edicionin e tretë të konferencës "Sporti dhe Media", ku edhe këtë vit kishte debate të ashpra rreth pasqyrimit të aktiviteteve sportive në mediat televizive dhe ato online. Konferenca është zhvilluar në formë panelesh, në njërën anë drejtuesit e sportit dhe në anën tjetër gazetarët sportivë. Nga drejtuesit e sportit, krahas përfaqësuesve të lartë të federatave sportive, në panel kanë qenë edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, Ibër Alaj, si dhe përfaqësues të lartë të federatave sportive në Kosovë, raporton "ksp". Në panelin e medieve, krahas drejtuesve të ShGSK-së dhe mediave vendore, të pranishëm ishin edhe Dëfrim Methasani, gazetar shumëvjeçar i Radio Televizionit Shqiptar, si dhe Faton Zylbehari, zëdhënës i Federatës së Futbollit të Maqedonisë dhe KF Shkëndija. Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë se pret që nga kjo konferencë të dalin shumë përfundime që do t'u ndihmojnë gazetarët dhe komunitetin sportiv. "Kjo konferencë është në përputhje me planin strategjik e caktuar një vit më parë. Tashmë kjo ka karakter tradicional dhe do të mbahet çdo vit duke trajtuar tema që e shqetësojnë komunitetin e sportit. Pres nga gazetarët që pikërisht në këto objektiva strategjike të vënë fokus në mënyrë që audiencia të informohet se sa po realizohen



këto objektiva", ka thënë Hasani. Kryetari i Shoqatës së Gazetarëve Sportivë, Edmond Thaqi, u shpreh se kjo shoqatë në vazhdimësi është duke punuar të ofrojë kushte më të mira të punës për gazetarët sportivë. "Për shoqatën është e mirëseardhur edhe kjo konferencë. Sigurisht që ne si shoqatë prioritet e kemi shtimin e kapacitetit të numrit të gazetarëve sportivë. Si bord i ri, së bashku me instancat sportive, jemi të gatshëm për ta dhënë kontributin tonë. Shpresoj që nga kjo konferencë të dalin përfundime që kanë të bëjnë me të mirën e komunitetit", ka thënë Thaqi. Drejtori i Departamentit të Sportit, Ibër Alaj, evidentoi pikat të cilat, sipas tij, mund të shërbejnë në të mirë të relacionit organizata sportive dhe gazetarë sportivë. "Për mua çështja e parë është ngritja e një programi në Universitetin e Prishtinës, edukimi për media. Pikë tjetër është lajme të rreme, të cilat citohen njanjëherë nga burime të brendshme. Në shoqërinë moderne, sporti dhe media kërkojnë marrëdhënie të mirë që ta rrisin prodhimin dhe vlerën", ka thënë

Alaj. Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, u shpreh se marrëveshja e nënshkruar me Agjencinë e Lajmeve "KosovaPress" i ka shërbyer këtij institucioni që të jetë edhe më afër mediave. "Komiteti Olimpik i Kosovës e ka krijuar një bashkëpunim shumë të mirë me mediat në Kosovë. Ne kemi shumë aktivitete, mirëpo këtë çështje të mirë me media na ka ofruar edhe nënshkrimi i marrëveshjes me 'KosovaPress'-in. Është shumë e rëndësishme për ne të jemi partnerë për media. Ne me media kemi qenë partnerë shumë të mirë derisa ka hyrë në fuqi Ligji për sponsorim. Prej këtij momenti mediat e kanë ndaluar ritmin e tyre", ka deklaruar Haxhijaj. Temat që u diskutuan në këtë konferencë ishin sfidat e sportit me mediat dhe anasjelltas, hapësira mediale e aktiviteteve të federatave në media, hapësira mediale e sportit të Kosovës në Shqipëri dhe Maqedoninë Veriore dhe anasjelltas, lajmet e rreme dhe ato të kopjuara, gjetja e formave më të mira të bashkëpunimit në mes të komunitetit të sportit dhe medias etj.

Clippersat fitojnë derbin kundër Lakersave

LOS ANGELESE, 26 DHJETOR - Clippersat e fituan me rezultat 111-106 derbin e Los Angelesit ndaj Lakersave. Ndeshja u dominua shumicën e kohës nga Lakersat, ku u dalluan Kuzma me 25 pikë, Davisi me 24 pikë dhe LeBroni me 23 pikë e 10 asistime. Në kahun tjetër u dallua Kawhi Leonard, që realizoi 35 pikë e 12 rebounde për Clippersin, duke bërë diferencën në parket. Zhgënjën edhe Milwaukee, që u mund 121-109 nga Philadelphia, me të pestë titullarët e ekipit vendës që realizuan mbi 10 pikë (Embiid 31 pikë e 11 rebounde më i miri). Për Bucks zhgënjëu Antetokounmpo, me vetëm 18 pikë,



ndërsa më i miri për miqtë ishte Middleton me 31 pikë, por që mbetën për statistikë. Befason edhe New Orleansi, që e mposhti me rezultat 112-100 Denverin, takim që u dominua nga miqtë, me Ingram që realizoi 31 pikë, duke i bërë të pavlefshme 23 pikët e Jokiqit për Nuggetsin.

Skuadra e Bostonit, falë 30 pikëve të Brownit dhe 22 të Walkerit, triumfoi 118-102 ndaj Torontos (VanMeer 27 pikë), ndërsa Golden State mposhti 116-104 Houstonin. Titullarët e Warriorsit në një mbrëmje magjike, ku të gjithë realizuan mbi 18 pikë, duke i bërë të pavlefshme 54 pikët e dyshes Harden-Westbrook.

REZULTATET

Toronto - Boston	102-118
Philadelphia - Milwaukee	121-109
Golden State - Houston	116-104
Lakers - Clippers	106-111
Denver - New Orleans	100-112

SHKURT

Cavani e shtyn për verë kalimin tek Atletico

Sulmuesi Edinson Cavani nuk do të largohet nga PSG-ja në afatin kalimtar të janarit. Edhe pse pak ditë më parë u fol për një akord mes sulmuesit dhe Atletico Madridit, një transferim i tillë mund të ndodhë, por vetëm në korrik. Drejtuesit e Atletico Madridit shpresonin që ta kishin Cavinin që në muajin janar, duke i paguar PSG-së një shumë simbolike, por ka qenë vetë sulmuesi ai që ka kërkuar ta respektojë kontratën që përfundon pikërisht në përfundim të këtij sezoni. Edhe pse ka humbur vendin e titullarit pas transferimit të Mauro Icardit, Cavani sërish mbetet një idhull për tifozët dhe diçka e tillë duket se e ka shtyrë atë ta respektojë kontratën me kampionët e Francës.

Tri klube angleze e duan Coutinhon

Bayern Munchen ende nuk ka vendosur se a do ta blejë përfundimisht yllin brazilian Philippe Coutinhon, i cili është i huazuar nga Barcelona. Gjermanët nuk duken të bindur për t'i shpenzuar 120 milionë euro për blerjen e ish-futbollistit të Interit, Espanyolit dhe Liverpoolit. Ndërkohë, siç shkruan e përditshmja spanjolle "Mundo Deportivo", Coutinho pëlqehet nga tri skuadrat angleze Chelsea, Manchester United e Tottenham.

Ibra i thotë "po" Milanit

Zlatan Ibrahimoviç është një hap larg nga kalimi te Milani, teksa thuhet se ka dhënë edhe miratimin e tij për të kaluar te kuqezinjtë. Sipas ekspertit të njohur të merkatos dhe gazetarit italian Gianluca Di Marzio, thuhet se Ibrahimoviç i ka thënë "po" propozimit të marrë nga Milani. Raportohet se tashmë mungojnë vetëm detajet përfundimtare, për t'u bërë më pas edhe zyrtare rikthimi i suedezit te kuqezinjtë. Pikërisht marrëveshja e fundit mungon dhe klubi italian po mendon që t'i mbyllë të gjitha procedurat sot (e premtë) dhe më pas ta zyrtarizojë afrimin e gjigantit suedez. 38-vjeçari pritet të firmosë një kontratë 6 mujore me "Djallin", ku do të përfitojë 3 milionë euro me mundësi rinovimi edhe për 1 vit pastaj, në bazë të paraqitjeve të tij.


Ronaldo: Tani për tani unë nuk jam i interesuar të bëhem trajner

Cristiano Ronaldo thotë se nuk pret që të bëhet trajner pasi të dalë në pension, por nuk është i gatshëm ta përjashtojë mundësinë plotësisht. Portugezi është akoma në formë pavarësisht moshës (34-vjeç), duke shënuar 12 gola në 21 paraqitje për Juventusin këtë sezon. Fituesi i pesëfishtë i "Topit të Artë" ka thënë në gusht se ai nuk e di se kur do t'i japë fund karrierës së tij, duke thënë se ai ose mund të tërhiqet në fund të sezonit ose të vazhdojë deri në moshën 40-vjeçare. "Tani për tani unë nuk jam i interesuar të bëhem trajner, por mbase një ditë do të mërzitem dhe do të ndihem se kam nevojë", ka thënë Ronaldo për DAZN Italy. "Kurrë mos thuaj kurrë. Nëse do të bëhesha trajner, unë do të isha motivues, trajneri duhet t'ia kalojë pasionin dhe talentin e tij skuadrës. Për shembull, më pëlqen të argëtohem, të dribloj, të godas, të shënoj gola. Këtë duhet ta kaloj tek ekipi si motivues", ka shtuar Ronaldo.

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!


BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqët tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përfutur nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.